

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-9

K14

ARIAN
KADIU

TAKIMI I PARE

novelë e treqime

814-52

K14

S

ARIAN KADIU

TAKIMI I PARË

tregime dhe një novelë



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

I

Në oficinën e gjatë si kazermë buçisnin motorët.

Inxhinieri urdhëroi të montonin ruspat¹⁾. Me-kanikët me llërë tërë graso ju përveshën punës.

Traktoristët u ngjitën në kabina. Maqinat e hekurta u drodhën, pastaj nisën të ecnin.

Po binte një muzg i butë. Bardhësi bore!

Tutje nga perëndimi dukeshin gjurmat e zbeta të një ylberi që po shuhej.

Zinxhirët e rëndë, të vajosur sërish, lëviznin lirshëm, prisnin në mënyrë simetrike akullin dhe linin prapa katërkëndësha kënddrejtë.

Portieri plak doli nga kabina e tij e ngrohtë, ku dremiste gjithë ditën, dhe i shtyu me forcë dy kanatet e hekurta të portës që u hapën me gërvimë. Aty traktorët ndaluan. Traktoristët zbritën dhe u përqafuan me shokët.

— Hajt, mirë ardhshi!

— Me suksese!

1) ruspat — janë presat ose thikat e mëdha metalike që kanë përpara traktorët dhe buldozerët për rrafshim ose heqje dheu.

— Të mirë u pafshim!

Drejtori dhe sekretari i partisë kishin qëndruar e po i vështronin me miratim e dashuri. I njihnin me dhëmbë e dhëmballë. Sa e sa net kishin kaluar pa gjumë verës e vjeshtës! Edhe në këtë kohë, kur e ftohta të detyron ta bësh me vrap copën e rrugës nga shtëpia në zyrë, do të niseshim përmes borës.

Nga oborri u dëgjua një zë:

— Hej, pritni se erdhëm!

Inxhinieri vraponte me një valixhe të verdhë prej dërrase, ku mbante veglat e punës për raste avarie. Kuzhinieri i shkurtër e trashalug nxitonte pas tij. Fadil Shpanaj bëri gjoja sikur nuk e pa dhe u tha shokëve:

— More, çudi, si nuk kam parë gjer më sot kuzhinier thatuq!

Qeshën. Ai kishte përgatitur ca ushqime dhe po vinte i ngarkuar me ato ndër duar.

— Ah, Fadil shejtani! Po ju kështu pa gjë, në dasmën time po shkoni?

— Qepe! — i tha Qazimi. — Të dëgjoi gruaja e ta ngjiti fletërrufenë!

Traktoristët i shtrënguan dorën me radhë duke qeshur.

— Mirë se të vini, djema! Ju presim me padurim. Kur të ktheheni, do t'ju bëj hallvë!

— Ta mbash fjalën! — thirrën ata.

Traktorët gumëzhitën e u nisën varg. Lanë prapa fjetoret dhe morën drejt qytetit. Bora kish arritur afër një metër. Traktorët turfullonin, e çanin atë dhe ecnin. Në rrugët e qytetit zhurma e motorëve të tyre thyente qetësinë e dimrit. Fë-

mijët u mblodhën një nga një dhe i ndoqën prapa duke cicëruar si rabecka. Më të mëdhenjtë dolën përpara portave të shtëpisë. I përshëndetën me dorë dhe i uruan:

— Udhë të mbarë!

Qyteti mbeti prapa.

Përpara udhëhiqte Fadili. Pas tij vinte Qazimi. Bashkë me këtë ishte inxhinieri. Trupat e tyre gjithë muskuj zinin gati gjithë kabinën. Në fund ishte Spirua. Ky kishte marrë me vete edhe ndihmësin e tij, Xhevdetin. Detyra e tyre ishte të spastronin borën, që kishte zënë rrugën nga qyteti gjer në qendrën e minierës. Rruga më e vështirë fillonte nga Mashellara.

Fadili çante pa u ngutur. Ruspa e madhe metalike e traktorit të tij futej thellë në borë, ngrinte peshë disa metra kub e, si bënte një rrotullim në vend, e hidhte pupël në një anë.

Qazimi dhe Spirua dhe traktorët e tyre më të vegjël e zgjeronin rrugën. Ecnin në anët e kundërta të saj dhe, duke u rrotulluar e kthyer, fshinin borën. Në këtë lloj rruge futej lirisht çdo lloj maqine.

Fadilit ju bë sikur dëgjoi zëra. Jehona e një kënge vinte valë-valë me të ulura e të ngritura, ashtu si në radiot me difekte. Tërhoqi marshin e e qëndroi në vend.

«Kush do të jetë? mendoj. Edhe pak dhe nata do të mbulojë çdo gjë».

Rrotulloi kokën. Në një brinjë shikoi të rrokulliseshin disa njerëz. Ata, ashtu kokë e këmbë, u vërtitën si topa të zez. Traktoristi qeshi padashur. Pastaj, duke dalë nga një shteg, ata sikur mbinë para traktorit. Ishin rreth tetë-nëntë veta. Dy prej tyre qenë të rritur, të tjerët fëmijë.

- Oh, tungjatjeta! — përshëndeti i pari.
- Tungjatjeta! Për ku kështu?
- Ja, gjer në këto fshatra këtu.
- Ç'jeni nisur kaq vonë?
- Mbaruam mësimin dhe... — tjetri hapi

krahët.

— Mësues? Po këta fëmijë nxënësit tuaj janë?

— Po.

— E tani ku po shkoni?

— Po i përcjellim për në shtëpitë e tyre. Janë të vegjël dhe s'mund t'i linim vetëm. Thonë se kanë dalë ujqër... — tjetri e preu fjalën dhe kafshoi buzën.

— E di, e di — tha traktoristi.

U afrua edhe mësuesi i dytë. Kishte mbështjellë kokën me shall leshi laraman. Hoqi dorashkën e i dha dorën.

— Si jeni?

Fadilit ju duk si zë femre. Dhe vërtet ashtu qe. Ajo ishte mësuese.

Qenki lodhur! Edhe andej s'duket fare rruga, ë?

— As edhe një shenjë. Ecim ashtu si në tym.

Mësuesit dhe nxënësit dukeshin të thinjur. Djersa e ngrirë ua kishte shndërruar flokët në fije të kristalta akulli.

— Ju dy mësues jeni në shkollë? — u interesua Fadili. të cilit i erdhi keq kur i pa ashtu të lodhur.

— Jo, jemi shumë. Në shkollën tonë vijnë shumë nxënës nga fshatrat përreth. Pjesën më të madhe të rrugës e bëmë së bashku. Pastaj u ndamë sipas fshatrave. Po ju?

— Po hapim rrugën.

— Ashtu? Ka rënë shumë borë! — tha mësuesja duke tundur kokën. — Në disa vende jemi futur deri në grykë. Të çash borën, duhet forcë e madhe!

«Shpesh mësueset na duken delikate. Kjo qenka e fortë dhe e zonja... si Shpresa», mendoi Fadili.

— Do një duhan? — Mësuesi nxori nga xhepi një letër najlon me duhan e fletë cigaresh. — E kam ashtu si pleqtë. Kjo e mban butë — tha.

— Faleminderit! Një herë tjetër, se po vonohem. Ikni edhe ju, se ju zuri nata.

— Epo, natën e mirë dhe vafshi shëndoshë! — thanë mësuesit.

— Natën e mirë, shoku traktorist! — thirrën nxënësit.

Njëri pas tjetrit ata u larguan dhe nisën këngë. Melodia e saj vinte përsëri valë-valë me të ngritura e të ulura.

«E lamë prapa Grapën», tha Fadili me vete.

* * *

Traktori linte pas një vazhdë të gjerë. Anash ngriheshin mure prej bore. Syri të shihte fusha bojë hiri, që shtriheshin pa mbarim. Nuk shquhej asnjë lloj bregoreje. Ai ndezi dritat. U dukën vetëm konture. Në qiell s'dukej asnjë xixë. Në një qoshe rrinte hëna e verdhë. Vetëm bardhësia e borës përleshej me errësirën e natës. Tutje qielli i errët ishte shkrirë me malet dhe tej dukej se ajo gjë e zezë, e stërmadhe dhe e pakapshme, që të dilte përpara, ta priste rrugën dhe s'mund të kaloje.

Traktorët e kanë vështirë në të përpjeta, megjithatë Fadili kishte ecur mjaft. Ai dhe shokët e tij e kishin bërë disa herë atë rrugë. Në fushat përreth shtrihet sektori i tyre. Ju kujtuan mbrëmjet e bukura të majit, kur ata punonin edhe natën. Javën e fundit të mbjelljeve, kur u hap pas një shiu që ra, ai lëroi tri ditë pa pushuar.

Tani puna qëndronte ndryshe. Ishte dimër dhe kudo kishte vetëm borë. Bora të lodh shikimin dhe të ndjell gjumin. Sytë i ishin skuqur. Fadili e futi ruspën thellë në borë, tërhoqi levat e drejtimit dhe eci, luajti levën e ruspës dhe e ngriti lart. Duart i mbetën të pafuqishme dhe traktori vijoi rrugën. Ai ndjeu një të tundur të fortë dhe koka sa s'ju përplas për xhami. Gjithshka ju errësua. Hapi menjëherë sytë dhe e pa veten të mbuluar me borë. U mblodh në vete dhe nuk mori frymë. «Po sikur»... Një ftohtësi dridhëse e pushtoi.

Në atë çast dremitjeje ai kishte ecur drejt dhe nuk kishte vënë re që hyri në një gropë.

Shkeli fort marshin dhe traktori rënkoi. I dha edhe një herë fort. Zinxhirët kërcitën dhe ai doli sipër. Eci disa metra prapa. U rrotullua në vend dhe filloi pastrimin aty ku e kishte lënë.

II

Në rrugë s'kish asnjë lëvizje. Bora ishte e virgjër dhe e pashkelur. Në një acar të tillë fshatarët rrallë dalin. I nxjerr nevoja. Me këmbë nuk udhëtohet, kurse me kafshë është edhe më vështirë. Çdo gjë e gjallë e ka zor të çajë borën.

Fadili ktheu kokën pas dhe ju bë se dy trak-

torët e tjerë s'po lëviznin. Qëndroi. Me të vërtetë ata nuk punonin. E ktheu traktorin në vend. Shkoi nga kishte ardhur duke shuar dhe ndezur dritat. Përpara i doli inxhinieri, duke tundur si lavjerrës krahët.

— Ç'ke? Mos të ka ndodhur gjë? — pyeti ai shumë i shqetësuar.

— Jo. Erdha t'ju ndihmoj.

— Po atëhere pse m'i shuan e m'i ndez dritat? Apo të duket pak ky dimër që na ka mbërthyer — ju shkreh ai.

Fadili kafshoi buzën.

«Po përse vërtet i shuaja e i ndizja dritat?!»

— Na bëre merak — tha tjetri i penduar. — Ka ngecur Spirua! — dhe u nis andej nga traktori tjetër.

Këtu ishte një barrakë. Në verë ishin hapur ca kanale për kullimin e ujërave. Kanalet qenë fare afër xhadesë. Spirua mund të kishte rënë në ndonjë kanal të tillë. Ai dëgjoi zërin e Xhevdetit, që ankohej:

— More, po ky desh na theu qafën. Pupupu! Hajde, Spiro, hajde!

«Po Leka, ndihmësi im, a do të kishte ardhur me ne po të ish aty? Patjetër. Sepse kam pasur mundësi ta njoh mirë ndihmësin tim, tha Fadili me vete. Por a do ta bënte atë që bëri Xhevdeti, i cili kërkoi me këmbëngulje të vinte me ne, megjithëse është i parratur sa duhet nga jeta? Po ku mund të kalitesh, po s'u ndeshe ballë për ballë me vështirësitë? Foli bukur në mbledhje qerratai: «Partia na mëson se jeta s'ka qenë, s'është e s'do të jetë kurrë kopsht me lule. Unë po bëj

stazhin për në parti, prandaj kërkoj të më caktoni atje ku ka më shumë vështirësi...» Dhe ja, erdhi me ne».

Spirua, që s'kishte folur gjer atëhere, pas pak tha:

— Ta tërheqim me kavo...

— Mirë — tha inxhinieri.

Fadili e Qazimi nxorën kavot. Njërën e kapi inxhinieri, tjetrën Spirua. Inxhinieri hoqi përpara; e çau borën me këmbë, pastaj me gjoks. Kavon e kishte vënë mbi sup dhe e tërhiqte me mundim. Pas vinte Spirua. Mandej u dëgjua një zë:

— Mos! Aty është hendeku.

Inxhinieri u tërhoq. Lidhën kavot.

Fadili e pa që po fërkonte pëllëmbët.

— U vrave?

— Më ka dalë pak lëkurë nga mollëzat e duarve — tha ai duke ndezur çakmakun.

— Mbushi pëllëmbët me borë e shtrëngoi. Të djeg pak, por ajo t'i përthan — tha Qazimi.

Me zor traktori doli.

— Nisemi, shokë!

— Jo, jo — tha me nxitim Spirua nga kabina.

— Motori kryesor i traktorit është nxehur shumë.

— Mos ndoshta ka pak vaj e duhet shtuar — tha Qazimi pa u menduar gjatë.

— S'e di — tha Spirua dhe zbriti.

— Vetëm të mos ketë blazë dhoma e djegjes — foli Xhevdeti.

— Ç'duhet bërë atëhere, o traktorist i ardhshëm? — e pyeti Fadili.

— Pse, ç'më kujton mua, o Fadil Shpanaj! Në SMT nuk kam ardhur të kaloj kohën — i tha Xhev-

deti me shaka. Pastaj shtoi: — Duhet hequr testata e të pastrohet.

— Bravo!

— E di se kujt i thonë bravo?

Edhe inxhinieri, që s'e kishte hapur gojën, qeshi. Ai kishte vështruar motorin e, pasi e kishte prekur me dorë, tha pak me inat:

— Aman, o Spiro, se na ngrive gjakun. S'e shikon që motori kryesor është nxehur fort se nuk ka ujë.

Spirua i ra kofshës me pëllëmbë duke thënë:

— Po kjo është kaq e lehtë, mor shokë, e unë nuk e vura re.

Ai mori kovën, çelësin e madh në dorë dhe vra-
poi drejt një pellgu që kishte zënë akull.

Fadili u ngjit në kabinë dhe u nis. Ai pa Spi-
ron që, si theu akullin, futi kovën në ujë.

Fadili kaloi me traktorin katër-pesë metra dhe grumbulloi me ruspe në një anë njëzet metra kub borë. E, ndonëse kjo u përsërit disa herë, maqina e hekurt nuk u lodh.

III

Për çudi, në rrezet e dritës që lëshonte trakto-
ri, Fadilit i bëheshin mijëra miza të vogla. Ju lo-
dhën kaq shpejt sytë? Jo. Binte borë. Ciflat e ho-
lla vinin si prej një site me dy shtresa pëlhure. Të
ftohtët u shtua. Duart dhe veshët i mërdhinin. Bora
i kujtoi të birin. E kishte shumë qejf borën. Ai
bënte njerëz prej bore me shokët e tij. Kishin
edhe një palë ski të vogla të lëmuara prej dërrase
dhe me to rrëshqisnin te Livadhet e peshkut.

«Tani është duke bërë gjumin e shqerrave»,
mendoi.

Zhurma e traktorit i kujtoi Fadil Shpanajt heli-
kopterin, i cili përsëri dje nuk ishte ulur, por i
kishte hedhur pakot me gazeta dhe postën te fusha
e sportit. Në atë kohë ai po hynte në dyqanin mba-
në udhës. Shitësi, kur mori vesh se kishte ditë-
lindjen e djalit, i dha edhe portokallet e vitrinës,
që kishin mbetur nga Viti i ri. Qeskat e tjera i
mbushi me arra, mollë. Bleu edhe ca pako fiqsh.

Tek po dilte, dëgjoi zërin e Gjergjit, i cili
po thërriste që nga rruga:

— O usta, usta! Një «Partizani» Gjirokastre!

Gjergji, kur i pa grykën e shishes, që dukej
nga xhepi i peliçes, i shkeli syrin në drejtim të saj.

— Raki, ë? E mirë, e shkreta — lëpiu pada-
shur buzët.

— Njëzetshe! — ju përgjegj Fadili.

— Duket se paske zënë ndonjë lepur e do t'ja
shtrosh sonte. Por vetëm sikur s'ka lezet. Sa herët
paske dalë për të gjuajtur, xhanëm!

Po Fadili, megjithëse e kishte pushim dhe e
kish pastruar çiften, nuk kishte dalë të gjuante.

— Pse, Shkëndija pasdite e kishte turnin? —
e kishte pyetur Gjergji.

— Jo, paradite ishte.

— Atëhere përse s'ja lë porosi asaj t'i blente
ushqimet, se një ditë si kjo s'duhet të kalojë bosh
— dhe vështroi nga malet, ku akoma binte borë.

— A, për festën e djalit jam gjallë vetë e
s'kam nevojë të përzihet ajo në të tilla raste.

— Pse?

— Si pse? Po unë jam i ati, ajo është e ëma.

— Nejse, — tha tjetri — por do t'ja shtronim

bashkë sonte, apo jo? Mirë, ikë tani se u thamë.

Fadili buzëqeshi dhe shtroi me dorë tufën e flokëve mbi ballë. Shkoi rrëzës e u drejtua për në mensë. Kishte trup mesatar e fytyrë të mprehtë. Sytë e gjallë i lëvrinin poshtë qepallave, sikur kërkonin gjithnjë të zbulonin diçka të re, cipën e lëkurës e kishte të rrahur nga dielli dhe era. Duart e ashpra, regjur nga nafta e benzina, si dru bungu me lëkurë të trashë, të pjekur e plot braza.

Si hëngrën drekën, ai pushoi mbi minder një copë herë. «Do ta kaloj mirë sonte, pat menduar. Në të ngrysur do të kthehem në shtëpi. Shtrihem e pi një çaj të nxehtë. Kur të vijnë shokët e djalit, do të shkoj në dhomën tjetër. Atje, i shtrirë, do të dëgjoj radion e do të lexoj gazetën. Do të vijë edhe motra bashkë me të shoqin dhe fëmijët». Me këto mendime në kokë s'e zuri gjumi. U ngrit e, ngaqë s'kishte se ku të vinte se qe shpejt, u nis për në SMT.

Nga ofiçina vinin kohë pas kohe të thirrura. Ai u ndodh atje kur erdhi Xhevdeti dhe i lajmëroi se i kërkonin të gjithë në drejtori. Në zyrë, veç drejtorit e sekretarit të organizatës bazë, ishin edhe sekretari i komitetit të partisë për rrethin dhe një instruktor.

Xhamet qenë veshur me një tyl avulli. Dikush zbërtheu jakën.

Pas fjalëve të para sekretari i komitetit të partisë i pyeti se si ishin me gatishmërinë teknike.

— Në përgjithësi mirë — u përgjegj inxhinieri.
— Disa i kemi gati. Ja, tani, para se të na lajmëronit të vinim, vumë edhe një në lëvizje.

— Shumë mirë, shokë! Se nga dita në ditë na dalin detyra të reja e, po s'qemë ne të maqi-

nerive gati... — tha drejtori, i cili s'u kuptua pse e la mendimin përgjysmë.

Sekretari i organizatës bazë, një tornitor, u foli për mbledhjen rrufe të byrosë:

— Rruga automobilistike është zënë prej borës. Për nevojat e rrethit, ajo është e nevojshme që të hapet. Sikur jemi ndarë nga Republika. Detyra është tepër e rëndësishme dhe e vështirë. Mendimi ynë është që rrugën ta hapin traktorët tanë. Por këtu fjalën e fundit e ka masa, vetë ju».

Fjalën e mori menjëherë Gjergji, i cili kërkoi leje me zë të ulët.

— Folë, o Gjergj! — i thanë.

— Rruga duhet të hapet... Detyra është e rëndësishme. Po është edhe dimër. Të ngrin palca... Është shumë ftohtë, shokë. Të presim ndonjë ditë. Edhe moti do të zbutet. Përjashta ka rrezik e të çajnë ujqërit. Pse të ngutemi e ta marrim veten në qafë?

— Ti mos e përdridh llafin! — buçiti i zemëruar Spirua. — Më caktoni mua!

— Edhe mua! — tha Bujari, një traktorist tjetër.

— Mua!

— Ju lutem shkruani emrin tim! — u nxitua Fadili.

— Jo, bre shokë! S'kam kundërshtim — dëgjuan zërin e ulët të Gjergjit. — Mund të vij edhe unë. Veçse kisha ca punë. Është edhe pak ftohtë. Por, po qe nevoja, vij unë.

— Jo, ky le të rrijë këtu. Se, kur është fjala për vështirësitë, duhet t'ja vënë të tjerët shpatullat punës e jo Gjergji. Jemi gati unë dhe Marku — e ngriti zërin Xheveti.

— Mjafton, shckë! — Sekretari i organizatës bazë për ndërmarrjen u afrua dhe u rrahu shpatullat. — Po ju, shoku inxhinier, si mendoni të veprojmë?

Ata ishin në këmbë.

«A do t'ja dalim?» pyeti veten inxhinieri.

Vështrimi i tij kaloi mbi shokët. Në fytyrat e tyre nuk pa as edhe një dridhje muskuli. Njeriu është i qetë, kur është i paepur dhe e di se ç'duhet të bëjë. Kjo ja shtoi akoma besimin.

Inxhinieri uli ngadalë dorën, duke i kërcitur gishtërinjtë, që i mbështeti fort mbi tryezë. Zëri, si telat e ndjeshëm të çiftelisë, ju drodh nga emocioni.

— Shoku sekretar! Me «S. 100» le të vijë Fadili, kurse Qazimi e Spirua me «S. 80». «Rrugës nuk i dihet», thotë populli. Me ta do të shkoj edhe unë — shtoi ai preraz.

— Dakord, shoku drejtor? — pyeti sekretari.

— Pregatituni për nisje!

Dhe, ashtu grup si ishin, dolën që të gjithë nga zyra. Fadili doli me shokët, por në oborr u kthye dhe shkoi në mensë. Atje mbështolli në një pako të madhe sendet që kishte blerë dhe ju lut Dalipit, një ndihmësi të ri, që t'ja dërgonte në shtëpi. Shkroi shpejt e shpejt edhe këtë letër:

«Agim!

Më fal, se sonte nuk vij dot në shtëpi. Na ngarkuan si detyrë që të hapim rrugën gjer në minierë. Ti u bëfsh njëmijë vjeç! Mëmës i thuaj të mos ketë merak.

Të puth, babai yt që të do shumë».

Ndihmësi, që po e lexonte, i mbajti dorën.

— Jo, jo, ti mos shko. Në shtëpi të presin për

ditëlindjen e djalit. Sot ke pushim. Vete u them unë atyre — dhe la pakon përmbi tryezë për të dalë. Traktoristi e kapi fort për krahu, e ktheu nga vetja dhe, si vuri buzën në gaz, pak i zemëruar, i tha:

— Prit! Po ti a do të ishe kthyer?

IV

Para apartamentit të Fadilit ndihmëstraktoristi Dalip dredhoi në shtegoren e çelur në borë nga kalimtarët dhe eci me kujdes për të mos u rrëzuar. Një grup të rinjsh gjimnazistë, veshur me tuta, po vinin me ski në krahë dhe nga fjalët e tyre e kuptoi se ata kishin lizgatur në kodrat e Kubenit. Ca fëmijë po shkisnin në një rrëshqitëse, kurse dy të tjerë po hidhnin ujë në një vend tjetër, që të ngrinte sa më shpejt e të forcohej akulli.

Te shkallët e hyrjes së parë, ku bora kishte bërë një mbiprak, Dalipi u pengua dhe ra në gjunjë, por pakon e shtrëngoi fort në gjoks. Fërkoj gjunjët me dorë dhe u ngjit lart. Derën ja hapi Shkëndija, e shoqja e Fadilit, e cila e ftoi brenda për t'u ulur.

Mbi tryezën e bukës, ai pa mjaft libra të rinj, fletore, çokollata e paketa llokumesh. Shkëndija i tha:

— Ja kanë sjellë Agimit shokët, se ka ditëlindjen sot — dhe bëri me kokë nga dera e dhomës tjetër, nga ku vinin të qeshura e biseda të bëra me zë të lartë.

Paradhoma ishte e ngrohur dhe e pastër. Në një anë të saj, një perde gjithë trëndafila e lastarë ishte hapur përgjysmë e dukej një shporet që ndizej, mbi të cilin ishin vënë tri tenxhere alumini. Një lulevarëse zgjatej nga vazua gjer afër minderit të mbuluar me stofë të trashë vishnje. Kur Shkëndija e qerasi me pije dhe biskota të vogla të ëmbla, ndihmëstraktori e kishte akoma në prehër pakon që i kishte dhënë Fadili në SMT. Ai deshi t'ja zgjatte gruas sa hyri, po ajo i dha dorën dhe s'pat se si. Kur pa këtë ambient të ngrohtë familjar dhe dëgjoji atë gaz të çiltër fëmije, që kumbonte nga dhoma tjetër, ai e gjeti të vështirë t'i thoshte se Fadili nuk do të vinte. Kur traktori i kishte dhënë pakon atij, i qe dukur se atë porosi mund ta kryente fare lehtë. Mirëpo tani që ishte errësirë dhe familja priste në gjirin e saj një njeri të dashur, ju duk punë fort e vështirë.

Si piu fërnetin, uroi me gjithë zemër:

— U bëft njëqind vjeç! — mandej me gjysmëzëri shtoi: — Fadili do të vonohet pak, se i çmontuan motorin një traktori dhe nuk ja gjejmë difektin — u skuq, ngaqë gënjeu, ndaj i tregoi shpejt e shpejt për ku ishte nisur i shoqi. Ngriti pakon dhe e vuri mbi tryezë. Shkëndija kishte qëndruar me tabaka para tij dhe e shikonte këtë djalosh të parrahur nga jeta.

Agimi, që pandehi se kishte ardhur i ati, hapi derën me vrull dhe hyri, po, me të parë mysafirin, mbeti aty. Dalipi i dha dorën. Ai ishte një djalë me trup të imët, nja tetë-nëntë vjeç. Kishte flokë të zez kaçurrel dhe sy të zez xixëllues. E ëma i dha letrën që i dërgonte i ati dhe i tregoi me hollësi.

përse ai nuk do të vinte. Djali me sytë në letër tha me naivitet:

— Po unë kisha përgatitur një vjershë të bukur, që do t'ja recitoja babit në darkë... Dhe bashkë me shokët do të këndonim këngën e traktoristëve.

E ëma buzëqeshi dhe hapi pakon, që kishte dërguar i shoqi. Letra e madhe mbuloi librat dhe dhuratat e shokëve. Ndhimëstraktoristi i përkëdheli me dorë flokët, kurse djali rrinte kokulur, i vrejtur e shikonte qeskat e mbushura.

— Ç'mendon — e pyeti e ëma.

Ai ngriti kokën e tha:

— Librat.

Kurse mendonte babain, borën dhe festën e tij.

V

Bora nisi të lëshonte një dritë të venitur fosforeshente. Po afrohej mëngjezi.

Fadili hyri në stacionin e parë. Qetësinë e akullt e prishte vetëm krakavitja e dëshpëruar e sorrave, që vinin rrotull për të gjetur ushqim.

«Sikur ta kisha çiftin tani, do t'u bija flurë», mendoj me vete.

I njihte ai ato vise. Atje ishte një fshat i madh. Verës fushat zienin nga njerëzit që merren me bujqësi. Shtëpitë janë shpërndarë fushës së gjerë e të begatë. Traktoristi mundi të dallonte furrën e bukës, që nxirrte tym dhe disa mullarë bari të renditur në një livadh.

Një njeri po vinte drejt tij duke dihatur. Ai thërriste:

— Sa mirë, oh, të lumshin krahët!

Kooperativisti dukej i turbulluar. Me duart e mëdha e të zeza përkëdheli zinxhirët, rrotat, kabinën.

— Po ç'është, more shok? — e pyeti Fadili, që s'kuptonte gjë.

— Hej, ti, s'ta shpërblejmë dot! Na shpëtove nënën, për nder, po.

Traktoristi mblodhi përsëri supet.

— Është e sëmurë nëna — i tregoi ai — dhe duhej dërguar në qytet. U munduam me ndihmë-mjekun ta nisnim me kalë, por bora s'çatej. Kali do të na ngordhte rrugës nëna do të na ngrinte. As maqina e kooperativës s'ecte dot e, kur e provuam njëherë, ngeli.

Kur u afrua, Fadili pa nën strehën e një hangari tri veta që po ngroheshin në një zjarr. Shoferi i kooperativës e njohu dhe u afrua.

— Ke ardhur sikur të të kishim porositur. U bënë dy ditë rresht që po dalim, se duam të dërgojmë një grua në spital, mirëpo të linte bora?..

— I ke vënë zinxhirët maqinës?

— Jo.

— Shpejt, o burra! — e nxiti Fadili.

Rrëmbyen dy palë zinxhirë dhe, me ndihmën e dy burrave, i lidhën rrotat. Pastaj Fadili e ndihmoi shoferin të ndizte motorin.

— Ki kujdes nëpër kthesa, — i tha — se ka akull. Pakëso shpejtësinë dhe udhëto me njëzet-njëzet e pesë kilometra në orë.

Maqina u nis.

— I shpëtove jetën nënës — i tha një çunak i thatë. Ishte djali tjetër.

— E kam për detyrë, o rini!

Traktoristi nuk ndenji më gjatë. Vendin e takimit e kishin te Ura e gurit, nja dy kilometra më tej. Vazhdoi të hapte rrugën. Dëgjoji një krismë çifteje. Pas saj edhe një tjetër. Ca të lehura. «A vranë gjë?» I shkoi mendja te gjahu. te paioni i tij i madh.

Nëpër peisazhin e bardhë shikoi që po çapiteshin tre fshatarë, të cilët i kishin lidhur veshët dhe kokën me shami. U përshëndetën që larg me dorë:

— Të vaftë udha krua! — e uroi njëri.

Te Ura e gurit ishte një postë policie. Një polic kishte qëndruar te dera. Ai, sapo dalloj traktorin, që dha ballë nga një kthesë, u turr brenda. Doli me një tufë shokësh. Ata e përshëndetën me dorë me të thirrura gëzimi. E pritën krahëhapur. Fadili e ndali traktorin dhe u dha dorën. U fut e ndenji në dhomë aq sa mori një avull.

— Hë, shok, ç'është? Ke ndonjë nevojë? — e pyeti i interesuar komisari, kur e pa të dilte prapë. — Ju do të pushoni këtu, pastaj do të niseni.

Fadili s'diti ç'të bënte.

— Keni udhëtuar tërë natën e tani keni nevojë për një pushim të shkurtër — tha përsëri i vendosur ai.

Traktoristi u ngjit në kabinë dhe fiku motorin. Zbrazti menjëherë edhe ujin, se, po ta linte, për disa minuta ai do të ngrinte e bëhej kallkan. Një polic rrëmbeu sëpatën dhe shkoi të priste akoma dru. Fadili, që po dremiste, hapi sytë kur ai derdhi dy

krahë të mëdhenj me dru aty pranë sobës, që bu-
bullonte.

— Jashtë u dëgjua oshëtima e dy traktorëve.

Vështroi në dritare. Policët, entuziaztë, u kishin
dalë përpara shokëve të tij dhe u tregonin kufirin
e rrugës. Dëgjoi inxhinierin, kur urdhëroi të fiknin
motorët dhe t'u derdhnin ujin.

«Djal i mirë!» mendoi.

Atë kohë shokët u turrën brenda.

— Ou, Fadili, si e kalove?

— Rrugën e ke çarë mirë. Edhe Qazimi e Spi-
rua e kanë pastruar e zgjeruar si duhet — tha in-
xhinieri.

— Ah, ç'qejf këtu! — ja bënte herë pas here
ndihmësi i Spiros, Xhevdeti, dhe i kthente zjarrit
herë gjoksin e herë kurrizin. Katër traktoristët e
vështruan me sy të shkëlqyer dhe hoqën trikot e
leshta.

Policët u sollën pakot. I hapën dhe panë se ku-
zhinieri u kishte futur nga dy racione për vakt.
Njërën e kish mbushur me mish të skuqur. Ku e
kishte gjetur vallë atë kohë?!

U shtruan të hanin mëngjezin.

Flisnin me shoku-shokun e qeshnin

— Sa vjet të bëhen që ke mbaruar universite-
tin? — pyeti Spirua inxhinierin.

— Këtë verë mbush katër vjet.

— Ku të caktuan, kur mbarove?

— Në një-fermë të Fushë-Krujës.

— Një vit paske bërë atje. Dhe drejt e te ne
erdhe?

— Po, o Spiro.

— A, edhe bilardon atje e paske mësuar —
ja bëri Spirua, të cilin ai e mundte gati vazhdi-

misht. — Veçse të kam parë tani disa herë në klubin e sportit, pranë qoshes së pensionistëve, mos ke ndër mend të mësosh tavllën?

Buzëqeshën të gjithë pa të keq, ndërsa Spirua i kërkoi revanshin sa të kryenin detyrën e të arrinin në qendrën e minierës.

— Hej! — tha Fadili. — Në fillim, kur erdhe, veç shikoje e dëgjoje e ne na u duke, të them të drejtën, si tuhaf, si i pazoti, kurse pastaj na dole zhivë.

— Jo, more Fadil, jc. Po, vija nga një front pune në një tjetër dhe në fillim desha t'ju njihja ju, traktoristët. Tani më duket sikur tërë jetën kemi punuar së bashku, sikur jemi njohur kushedi që kur.

Pastaj inxhinieri u ngrit e shkoi te telefoni. Lajmëroi: «Gjithshka në rregull.»

Traktoristët ndjeheshin shumë mirë. Të ftohtët u iku dhe filluan muhabetin me policët e postës.

— Tani ejani të flini në dhomën tjetër — u tha komisari.

Ata ngurruan. «T'i shqetësojmë më tepër!» menduan

Inxhinieri lëvizi kokën si të donte t'u thoshte: «Do të flini.»

— Do të na lini të flemë vetëm pesë orë — u tha ai. — Llogariteni që tani e jo kur të na zërë gjumi. Mua më zgjoni pas tri orësh.

— Përse?

— Do të ndez zjarr e do të ngroh ujin për motorët.

— E bëj unë atë punë, se nuk kam shërbim paradite — tha një polic i gjatë e faqekuq. — Sa duhet nxehur uji? — tha.

— Pesëdhjetë gradë, dy viza e tre të dhjetat — foli duke u shkelur syrin të tjerëve inxhinieri, por shtoi shpejt e shpejt se mos i mbetej hatri tjetrit: — Gjersa të nisë të avullojë.

Policët, të kënaqur nga shakaja, i çuan në shtretërit e tyre.

Dita u hap. Re të bardha me një të kuqërremtë si petale mollësh lundronin në qiell. Ditë të kë-tilla dimri janë të mërzitshme.

Orët kaluan. Policëve u erdhi keq t'i zgjonin. Ishin mbuluar të gjithë me jorgan dhe po flinin me gërhima. Por detyra është detyrë, prandaj duhej t'i zgjonin.

Traktoristët u lanë dhe filluan të përgatiteshin.

Polici i gjatë e faqekuq dhe një tjetër kishin ndezur një zjarr të madh bubulak nën strehë dhe kishin vënë mbi të një kazan plot me ujë. Nga kazan avujt ngriheshin palë-palë.

Dy traktoristë shkuan të ushqenin zjarrin, që ujët të nxehej akoma. Inxhinieri, si mori ca vegla nga traktori i dytë, bashkë me Fadilin dhe Xhevdetin nisi të kontrollonte maqineritë. Ata bënë shtrëngimet e gjithë bulonerive të nevojshme. Inxhinieri kontrolloi ruspat se mos u ishin çarë thikat, pastaj, bashkë me Fadilin, pa se mos ishte këputur ndonjë vidhë, e tyre. Fadili kontrolloi nivelin e vajit.

Nxorën llambat me benzinë dhe që të pestë ju vunë punës. I ndezën dhe i vunë poshtë nën sotokarp¹⁾ që i hollohej vaji. Së bashku me policin e gjatë e faqekuq, të cilit kuptohej se i pëlqente mekanika, Xhevdeti dhe Qazimi hipën mbi zinxhi-

1) sotokarp — pjesë e motorit të traktorit.

rët e traktorëve të tyre dhe luajtën manivelat. Pas disa minutash motorinot lëshuan ca buçima të vogla, pastaj u ndezën motorët. U sulën të merrnin ujin e valuar me teneqe dhe mbushën secili depozitat. Inxhinieri, si u hodhi një sy nga afër të tre traktorëve, u tha shokëve:

— Gati, shokë! A nisemi?

— Po! — pohuan të gjithë.

— Kush ka nevojë për ndonjë gjë? — pyeti ai.

— ...

Inxhinieri falënderoi edhe për shokët të gjithë policët e postës.

VI

Traktorët gjëmonin dhe si të uritur çanin përpara.

Filloi të frynte një erë e ftohtë e fortë. Prej saj, të ftohtët sa vinte e shtohesh. Era ulërinte nëpër kodra dhe dukej sikur lëvizte vendi. Bora mezi hiqej. Era mundohej ta pengonte traktorin, po traktoristët ndiheshin të sigurt në maqinat e hekurta.

Ishin larg njëri-tjetrit. Në fillim ishte traktori i Fadilit, mjaft larg nga shokët, pastaj vinin Qazimi e Spirua në një distancë të afërt.

Në këtë furtunë Fadilin e tërhoqi një kodër aty afër. E njihte mirë vendin. Në vjeshtë kishte punuar me traktorin e tij për ta shpyllëzuar. Andaj ai

nisi një dialog të shurdhër e të brëndshëm me traktorin.

«E mban mend, kur kemi qenë atje?» pyeti pa zë ai dhe pa e përcaktuar se kujt i drejtohej: traktorit apo kujtesës së tij.

Traktori ecte përpara.

«Në thellësitë e atij pylli me shekuj nuk kishte hyrë njeriu. Të trembte errësira e thellë. Ahishtet dhe dushqet i kryqëzonin kurorat e tyre lart dhe vetëm në ndonjë vend qielli i kaltër dukej copa-copa. Drurët me trungjet e trasha nuk i mbërthenin dot tri veta të zënë për dore. Ne kishim për detyrë të hapnim tokë të re buke për kooperativën. Dhe ju futëm pyllit. Shpyllëzimi që punë e lodhshme dhe e vështirë. Drurët i lidhja me kavo. Ata binin me krismë duke u përpjekur pas të tjerëve dhe toka tundej. Pastaj u ktheheshim rrënjëve dhe i nxirrnim nga toka. Sa tokë e butë, çfarë dheu i shkrifët e pjellor! Në drekë, kur pushoja, i futesha pyllit thellë. Tërë sipërfaqja e tokës ishte mbuluar me luleshtrydhe dhe kulpra. Ulesha në tokë dhe mbushja grushtet. Ato që ishin pjekur më tepër, më kullonin lëngun bojë kremi në dorë. Këmbët më ngatërroheshin në kërcejtë e hollë e të gjatë të kulprave dhe rrëzohesha mbi gjethet e kalbura prej vitesh. Kësaj pranverë, aty, kooperativistët do të mbjellin patate.»

Fadilit i dhembnin duart. Mbi lëkurën e plasur duket sikur një dorë e kujdesshme ka bërë qindra vijëza me kalem të kuq. Edhe pulpat i mërdhijnë. I fërkon me njëra-tjetrën. Për disa çaste ato i dhembnin, pastaj sikur i qetësohen e i ngrohen.

«Të kisha një zjarr, do të ishte mrekullia vetë. Sa i mirë është zjarri!»

Pse të mos ndez nja dy karthia? Ja edhe pak. Po shkoj gjer tek ato drutë aty. Po, po, një zjarr do ta ndez. Mirëpo a nuk vonohet çelja e rrugës? Vonohet... po s'bëhet kiameti për një orë më përpara a për një orë më prapa. A duroj dot? Duroj, duroj, por, ama, po mora një avull, do të jetë më mirë.»

Ndaloi traktorin, por motorin nuk e shoi.

Bora i erdhi deri në gjunjë. Duke i ngritur këmbët lart, ai shkoi te një dushk i madh. U zgjat dhe kapi një degë. Bora u lëshua nga dega, i mbuloi kokën, i veshi sytë e i hyri në qafë. Fërkoj sytë me mëngën, që i binte erë naftë dhe qeshi duke u dredhur.

Këputi disa degë, shkuli tre hunj nga një gardh i rrëzuar dhe pastroi një copë vend me këmbë. Mori nga kabina çelësin e madh dhe hoqi borën gjersa doli toka e ngrirë. U hoqi drurëve cipën e akullit dhe shkoi e mori bidonin e vogël me benzinë. Lagu leckën, me të cilën fshinte duart, e ngopi me benzinë dhe e vuri poshtë. Ndezi shkrepset dhe ngadalë lecka e lagur mori flakë. Drutë kërcisnin, bënin tym, nxirrnin bulëza uji e ja bënin «shsh». Kapi bidonin dhe hodhi benzinë. Me një herë u ngrit një flakë si gjuhë kulçedre. Pak nga pak, flaka u platit.

— Hej, t'ëmën e ..! — shau me zë të lartë i nevrikosur. Mori prapë bidonin katërlitërshe dhe hodhi përsëri benzinë. Drutë e fikura e të thara u skuqën dhe zjarri u ndez. «Harxhova shumë benzinë, më duket», mendoj.

Disa dru qenë bërë prush, por flaka ra përsëri. Instiktivisht kapi bidonin. Kur po lironte kapakun, tha me vete:

«Po e harxhoj benzinën kot. E kemi kursyer me djersë e lodhje e tashti po e derdh si lopa kusinë me qumësht!»

La bidonin dhe u ul më gjunjë mbi borë. I fryu sa i fryu prushit dhe u ndez një zjarr i mirë.

U ngroh. Ngrohu duart e këmbët. E ndjeu veten si të lehtësuar. Thonjtë e këmbëve filluan t'i kruheshin ëmbël.

Ai u ul në bisht dhe po ngrohej. Sytë po i visheshin me një si perde të përhime e të trashë dhe atë gati po e kapllonte gjumi. Ndjeu të ftohtë në kurriz. Hapi me përtesë qepallat dhe pa se drutë qenë djegur dhe zjarri po shuhej. Duheshin akoma dru të tjerë.

«Sa kohë kam që po rri për t'u ngrohur? mendoj. A kam aq kohë për ta harxhuar kështu?» Pëpritur ai hodhi në zjarr borë dhe e shkeli me këmbë.

Hipi në traktor dhe luajti me shpejtësi levat.

VII

Zbriti në një rrafshirë të gjerë, e cila pritet e qarkohet përsëri nga malet. Verës shpateve të këtyre vërshojnë rrëkeza bjeshkësh e derdhen ujvara shkumbëbardha si mjellma pendëlehta. Tani në të dy krahët shtrihen fusha të tëra të bardha.

Ky kujtim i freskët i verës, kjo fushë e gjerë, që rrethohet me male, shpatet e prera i sollën para sysh fshatin e lindjes, ngjarjet e pashlyera të veçjëlisë.

Ishin një turmë çamarokësh këmbëzbathur. Nuk kishte plep e hardhi, gardh apo livadh, ku të mos

shikoje të vegjël, ku të mos ngrihej një kokë me flokët drudhë. Dikush vraponte me një këmishë në shtat, tjetri bërtiste nga maja e plepit, i treti kacavirej pas rrushve, të tjerët me bagëti derdeshin livadheve të blerta.

Paradite u ndihmonin prindërve. Shkonin me ta në fushë dhe punonin me kazma e lopata. Me prindërit e kushërinjtë zhbrenin qetë në vapë, uleshin hijeve e shtroheshin para poçit me dhallë, gjizës në gjethe kungulli dhe thyenin bukën me misër të verdhë në gjunjë.

Kishin një sedër të madhe e s'u bënte bef syri. Fadili kishte dëshirë të luante me më të rriturit, prandaj i ndiqte ata këmba-këmbës. U vinte pas në mal për dru, i mbante në kurriz gjatë lodrave, por, megjithkëtë, kur vinte puna, ata nuk e pranonin në shoqërinë e tyre. Ai nuk kishte dhënë «prova burrërie e trimërie». Ata kishin një zakon të çuditshëm. Pavarësisht nga dëshira dhe mosha, në fshatin e tyre nuk quheshe burrë e nuk të futnin në shoqëri pa dhënë «prova».

Kur ju nënshtroa provës, Fadili ishte shtatë vjeç. Kjo ishte një ngjarje e shënuar në jetën e tyre. Fëmijës që donte të pranohej në shoqëri i vinin në llërë një eshkë të ndezur. Këtë duhej ta mbaje në mish gjersa të digjej plotësisht e të shuhej aty. Më të mëdhenjtë nxorën nga xhepat strall e çelik. Vunë eshkë dhe, me të goditura, e ndezën. Njëri ja leu vendin me pështymë dhe i ngjitën eshkën e ndezur. Ju e dini se sa ngadalë digjen ato fijet e holla të eshkës. Ajo nxjerr një tym të lehtë sa mezi shihet. Prova e parë që e vështirë dhe e rëndë. Fadili shtrëngonte dhëmbët dhe ndjente erën e lëkurës së tij që digjej. Ai kishte të drejtë të lë-

vizte pak krahun, ndërsa, po ta flakte eshkën, turpërohej keq e cilësohej edhe frikacak. Ai duroi me një vullnet të madh deri në fund. Por ky ishte vetëm fillimi, sepse ai i dogji llërët edhe disa herë të tjera. «Trimat» nuk duhej të kishin vetëm një she një mbi lëkurë dhe ai, si trim që ishte, i qëndisi mirë krahët.

Ju kujtua ai Fadili i parë i imtë, i zbetë e kockë e lëkurë, që e kishte parë në vegjëli në copa pasqyrash. Ishte dhjetë ose njëmbëdhjetë vjeç atëhere, kur, në një kopsht, ai ishte takuar me një varg njerëzish më të varfër e më të paveshur se ai vetë, por me yll të kuq në ballë. Ai kishte dëgjuar për partizanët, trimëritë dhe ndodhitë e të cilëve, që pëshpëriteshin gojë më gojë, i shikonte edhe në ëndërr. I kishte parë edhe prej së largu, kur ata i kishin zënë pritë dhe i kishin vënë zjarrin një autokolone. Një natë kishin pritur e përcjellë në shtëpinë e tij tre prej tyre. Bile në dhomën e vogël kishin strehuar një javë rresht një partizane të plagosur. I ati ishte ndërlidhësi i fshatit me batalionin, gjersa doli partizan. . .

Traktoristi ndjeu erën, që frynte nga veriu; shikoi vendet me borë, që zbardhnin rrotull; vetëm në lindje, nën vijën e largme të horizontit, toka dukej sikur avullonte, e mbytur në mjegulla të lehta ngjyrë manushaqe.

VIII

Fadil Shpanaj dëgjoi ulërима. U ndal për një çast dhe mbajti vesh. E kuptoi se ishin ulërима

ujqërish. Kopetë atij dimri të egër kishin sulmuar rrugët, ndonjëherë edhe fshatrat. Ai pa të rrokullisej prej rrëpirës aty afër një gjë rrumbullake e murme, që u përplas te një pemë dhe s'hodhi dot më asnjë hap. Një lepur. Disa egërsira e ndiqnin. Ishin pesë a gjashtë ujqër. Përpara u printe një ujk i zi. Ishin të uritur. Duke u lëkundur nga ethet e urisë, nga grykësia, ata vraponin me kokën poshtë. Një minutë u bashkuan kokë më kokë dhe skërmnitnin dhëmbët e verdha. Nga goja u ngrihej një ayull i lehtë. Me ulërime i vinin rrotull lepurit. Nga faqja tjetër e kodrës lepurit duhej të ishte ngjitur vetëtimthi dhe i kishte lënë ata prapa. Në të përpjeta lepujt ngjiten më shpejt, kurse teposhtë e kanë vështirë të vrapojnë, se këmbët e pasme i kanë më të gjata se të përparmet. Kështu që, kur zbresin, nuk vrapojnë, por rrokullisen.

Fadili ja shtoi gazin më tepër traktorit.

Brenda një sekonde, ujqërit e çanë lepurin. Futën turinjtë në gjakun e ngrohtë. U ulën në bisht si rrallë ndonjëherë dhe, me qejf e hëngrën mishin e tij. Në raste të këtilla egërsia e tyre arrin kulmin dhe ata nuk i tremben as plumbit. Fadili ndezi dritat. Ujqërit e kanë frikë zjarrin dhe nuk afrohen.

Stuhia ngriti borën përpjetë dhe e përplasi ku mundi. Fadili u përpoq ta pastronte mirë udhën automobilistike, që shokët të bënin vetëm punën e tyre. Por suferina e vështirësoi këtë. Qazimi, prapa, në mjaft vende, e hapi rishtaz udhën, sepse e mbushi era. Furtuna, si një nxënëse e pakujdeshme, e fshin si me gomë tërë punën dhe e mbush përsëri me borë. Qazimi ecte me traktorin e tij dhe grumbullonte e shtynte borën. Ngrinie ruspën pak

lart. Përparonte kështu gjer në dy-tri metra, e rrafshonte borën duke lënë një shtresë. E ulte ruspën gjer në fund dhe vijonte më tutje udhëtimin. Tjetri, që vinte pas, Spirua, e fshinte atë që linte shoku dhe hiqte edhe borën që e përplaste stuhia. Ishte ftohtë, shumë ftohtë. Të ftohtët sikur shtohet vetiu, kur mendon se edhe ambienti përreth është krejt borë.

Papritur udha sikur mori jetë, ngjyrë, sikur ju shtuan disa nuanca të këndshme. Fadili ndjeu tingujt e një gërnete, që ja kishte marrë bukur popullore «Furfullon fëllanza». Duke u afruar, dëgjoi edhe një lodër, që, si xhezband, i mbante ritmin.

«S'po më kalon dita kot», mendoi.

Kur u afrua në vend, muzika pushoi. Në anë të rrugës ai pa dy muzikantë.

Më tej ai pa dy grupe njerëzish. Në mes tyre gjëja e parë që i ra në sy Fadilit ishte nusja. Nusen, mbuluar me vello të bardhë dhe hipur në kalë, e mbanin dy veta për krahu.

Në xhade ata u ndalën.

Të dy grupet e burrave u vunë përballë njëri-tjetrit. Ai e kuptoi që njëra palë ishin përcjellësit e nuses dhe ana tjetër krushqit që e kishin marrë atë. Dy djem të veshur trashë mbanin për freri kuajt që turfullonin e shfrynin duke përplasur këmbët, se ua pickonte ngrica si mizë. Mbi samar u kishin hedhur

velenxa të larnie me ngjyra të ndezura, ku zotëronte e kuqja.

— Besoj se krushku ka mbetur i kënaqur! — tha ngadalë dhe hijerëndë daja i nuses, një burrë me mustaqe të thinjura. — Nuk i kërkuam të sjellë rroba për cucë e nuse.

— Or dajë! Iku ajo kohë tani. Ne qysh atëhere ju thamë se s'duam rroba as për vajzëri, as për nusëri.

— Ti mos i dil fjalës përpara — i tha daja të riut, që ishte nga ana e nuses.

I pari i krushqve nxori nga xhepi një shishe me raki dhe ua kaloi dorë më dorë përcjellësve duke filluar nga daja.

— Na qoftë për hair! — uronin ata njëri pas tjetrit.

Si pinë ata nga ana e nuses, atëhere nxori daja një shishe të veten me raki. Ua kaloi krushqve. Vetëm dhëndrri nuk piu, por ja kaloi shokut pranë. E ngriti edhe Fadili, që ishte vendosur aty në fund radhazi me krushqit dhe piu dy gllënka.

— Tashti na e dorëzoni nusen neve e mos kini hiç merak, se si bijën tonë do ta mbajmë — tha i pari i krushqve, duke u dhënë me dorë në zemër nga një cigare atyre të anës së nuses.

Burrat thithën cigaret.

— Ti — i tha i pari i krushqve vëllait të dhëndrrit — hiqi vellon.

Përcjellësit lëvizën! U ndje një murmuritje.

— Or mik, — tha ngadalë daja — të ish për ta nxjerrë zbuluar e me lule, e kishim nxjerrë vetë.

— Jo, ja hiqni! — u nxitua i riu nga ana e përcjellësve.

— Pusho, more ti! Kush na e futi, bre, këtë në listën e burrave? — pyeti, duke qërtuar vetullngrysur daja. — Shko e rri me ata shokët e tu atje — dhe tregoi me dorë djalin me qeleshe mbi sy dhe shokun tjetër të tij. — Bëjnë burrat llaf e jo...

— Kështu ka vendosur populli në kooperativën tonë — tha i pari i krushqve, duke u menduar.

— Ne kemi menduar t'ja heqim vellon — tha edhe vëllai i dhëndrrit.

— Në konakun tuaj na thatë që gjer në kufirin e fshatit tuaj t'ua çonim hatërin. S'ishte për t'u dhënë kjo fjalë, por ne e dhamë dhe bëmë njërin sy të verbër dhe njërin vesh të shurdhët.

— Or mik! Të mos e prishim tani në fund.

— E, që të mos e prishim, themi edhe ne.

— Mirë, po ç'rol luan velloja? — pyeti daja.

— E si s'luan rol! Luan që ç'ke me të. Ashtu ka vendosur populli atje — tha Fadili në atë kuvend të vogël.

Të gjithë e shikuan.

— Po ti ç'hyn këtu? — tha daja, pasi e vërejti mirë. — Nga ana juaj është ky që ngrihet këtu? Nga na doli?

I pari i krushqve mohoi me kokë.

— Shok është. Yni — tha dhëndrri, që u skuq në fytyrë, po që u kuptua se i pëlqenin fjalët e traktoristit.

— Me të vërtetë ju s'më njihni. Takova aty

pari dhëndrin me krushqit, që kishit lënë në rrugë. Bisedova me ta. Nusja e dhëndrri të rrojnë e të trashëgohen, por ama nuk duhet shkelur mbi vendimet e popullit. Kjo që thoni ju nuk është gjë e mirë — ju kthye dajës që kishte ngrysur akoma vetullat.

Dajës nuk i erdhi mirë dhe bëri sikur s'e vuri re. Të tjerët s'e zgjatën.

— Ju — e mori përsëri fjalën i vëllai i dhëndrrit — nuk pranuat që djali ynë, dhëndrri, të vinte me ne dy-tre të tjerët, të merrte nusen e tij të shtëpia juaj. Na e latë djalin të priste këtu në xhade. Tani doni që përsëri të shkojë fjala juaj, kështu s'bën!

— Or mik, po edhe këtë hatër na e çoni, e pastaj u bëftë si thoni ju, se e keni cucën në dorë.

Krushqit heshtën, se daja i shtrëngoi në fjalë.

— Me vendimin e popullit s'bëhen lëshime dhe s'duhet të ketë hatëre — tha Fadili. — Në fshatin tuaj a nuk është marrë një vendim i tillë në mbledhjen e përgjithshme të popullit?

Djali i ri nga ana e nuses deshi të fliste, por daja e vështroi vëngër dhe pastaj foli vetë.

— Është vendosur.

— Po ju? — pyeti traktoristi.

— Para një jave u bë mbledhja dhe dajës i vjen zor. Thotë: «Pse ta bëjmë këtë gjë ne të parët?» — tha me një frymë i riu nga ana e përcjellësve.

I riu nga ana e përcjellësve kafshonte buzën e mezi e mbante të qeshurit.

— Pastaj, tani është palca e dimrit e do t'i ngrijë fytyra — deshi të ngulte prapë këmbë në të vetën ai.

— Po fshati ynë ja ku është, — ja priti i pari i krushqve — ti sikur s'e di.

— Po na vjen zor, bre burrë, që të vijë zbuluar. Merreni me vello.

— S'kanë ndonjë ndryshim duvaku me vellon, — tha i vëllai i dhëndrrit — dallohen vetëm nga ngjyra, se që të dyja në të vërtetë janë të botës së vjetër.

— E nga ç'gjë të vjen zor? — ju kthye Fadili. Por s'priti përgjegje. — Unë jam punëtor, traktorist. Në SMT, kur vjen puna për të vendosur, vendosim vetë. Gaboj, më korigjon shoku: gabon shoku, e korigjon kolektivi. Ne kemi luftuar e luftojmë shumë mbeturina të së kaluarës. Partia na dha kra-hë. Neve dhe juve. Me fjalën e partisë në zemër, ne mund të çajmë edhe malet e jo më të mos shembim një zakon të keq, këtë të mbulimit të nuses.

— Bjerini gërnetës e daulles! Kemi dasmë këtu! Ti hiqi vellon nuses! — thirri i pari i krushqve dhe bëri toka me përcjellësit.

— Hej, na mundët, or shokë! Veç zakoni sikur na është mbledhur në kraharor — tha daja i nuses — e shpesh na zë frymën si të kishim azmën. — Ju kthye nuses: — Paç këmbën e mbarë, bijë, e të na trashëgohesh! Udha e mbarë edhe juve, o burra!

— Tungjatjetani!

Gërneta ja mori një melodie të bukur. Buçimat e traktorit përziheshin me të dhe sikur formonin një ritëm të pandarë.

— Falemnderit, or shok — i tha i pari i krushqve Fadilit. — A s'po vjen sonte në dasmë?

— Me gjithë qejf, por s'kam kohë. Ju qoftë për hair!

Dhëndrri shtoi me zë të ulët për të mos e dëgjuar të tjerët:

— Eja, eja në dasmën time!

Fadili buzëqeshi dhe ata shtrënguan duart me forcë.

Traktori buçet e rënkon, sikur është zemëruar me borën, e cila s'do që t'i bindet. Megjithatë, rruga duhet hapur me çdo kusht!

Dita kaloi e lodhshme.

IX

«Sa bukur po hyn e reja në jetën tonë të përditshme! Dhëndrri i ri dhe nusja e tij... Dajës i vinte zor vallë vetëm nga fjalët e botës? Në shpirtin e tij luftonte e vjetra si një masë e zeshkët dhe e tharë. Ajo s'e linte të hapte sytë e ta vështronte të vërtetën mu në bebëz, pa u tutur... E reja te ne po futet si një mekanizëm i hekurt e i fortë. Ç'përparime! murmuriti traktoristi. — Si ishim e si jemi! Kujtoj nusen e re dhe time shoqe, Shkëndijën. E në këtë luftë për ngritjen e tyre dhe ne burrat jemi lodhur, jemi përpjekur, që ajo t'ja arrijë qëllimit. Kur e mora Shkëndijën, m'u duk më e mira ndër shoqe. Ishte e zgjuar dhe e ditur. I ati s'më lejonte të veja ta shihja. Me këmbëngulje, vetëm pasi bë më celebrimin, u bë e mundur të hynte në kurs për infermiere. Dhe ishin gjithsejt tetë-nëntë infermiere. Si i dukej vetja ditët e para Shkëndijës! Gati sa s'fluturonte. Shkëndija s'kish ku të shkonte më

tepër. E s'ka se ku të shkojë. Për të unë bëra mjaft. Gratë e brezit tonë kaq mundën të ecin, sepse edhe këto që kemi bërë për to me sa vështirësi u arritën. Ne i shtymë e i përkrahëm të shkundnin nga supet gjithë pluhurin e së kaluarës, që e kanë mbajtur brez pas brezi, si një mallëkim të zi e të thekshëm nënat dhe gjyshet tona. Tani Shkëndijen s'e lë shtëpia, djali. Duhet punë edhe atje. Sa për amvisë, është e mirë, e pastër... Të rejave të sotme u bie të jenë në ballë, se këto janë më të hedhura, bile, dc të thosha, më të zonjat, ndoshta edhe më të zgjuara se gratë tona, se gruaja ime. Se, në fund të fundit, gjithshka ka një kufi, varet nga mundësitë, kryhet brenda tyre. E Shkëndija deri këtu arriti. Mjaft e ka».

X

Rruga, si një kordele e bukur dhe e shkëlqyer, kalonte pranë një fshati e humbiste nëpër bardhësi. Toka valëzonte si dallgët e detit.

«Nën borë tani ushqehet gruri, mendoj Fadili, gjersa të vijë pranvera. Hej, pranvera! Pranvera të deh me blerimin e saj të njomë!

Sa ditë kam shënuar në librezë gjer tashti? Edhe Leka realizonte nga një normë e gjysmë, ndonëse tërë mbrëmjen kërcente.

Në fillim pastruam borën dhe pastaj sulm me kazma. Maja e saj e nxirrte dheun copa-copa. Pak nga pak, por, ama, kur të vështroje prapa, ishte bërë një rrip i gjatë.

Më ngjan se kam shënuar pesëdhjetë e tetë ditë pune. Ej, bela, bela! Si na shikonin ato ditët e para pleqtë! Kur kaluam në mëngjez me të rinjtë rru-gës së fshatit, disa pleq u kollitën fort sa na panë, e ca të tjerëve u ishte ngulitur në kokë se në dimër s'ka punë. Ditën e dytë pasdite ata erdhën të na shihnin. Njëri, të cilit s'i rrihej pa folur, akoma pa u afruar mirë, na thirri: «E, more! E kush e çan bo-rën me kazmë, veç jush?!» Po, kur panë tokën e zezë, heshtën. Të nesërmen, kur vajtëm ne, ata i gjetëm në punë. E t'ja krisi daullja e kënga, vallja e shakaja, që hajde, more, hajde! Dhe, ndo-nëse të ftohtët arriti dhjetë gradë nën zero, asnjëri nuk u largua.

Më duket se do të bëj edhe shtatëdhjetë ditë të normuara për të plotësuar zotimin. E ky duhet tejkaluar patjetër. Por ndihmësi im, Leka, do ta rea-lizojë më shpejt premtimin. Ai është akoma në fshat. Sa mirë bëri! Shembulli ynë ndikon shumë atje.

Ç'ka qenë ajo mbledhje e bashkimeve profe-sionale? S'mund ta harroj dot!

Kryetari i bashkimeve profesionale foli shkurt e qartë. Propozohej që dimrit traktoristët e SMT-së të punonin në kooperativat e fshatrave të tyre.

Këndi i kuq gumëzhiu. Nja dy veta nga fi-llimi tundnin kokën në shenjë mohimi dhe flis-nin njëri me tjetrin, duke lëvizur duart. Tymi i duhanit endej mbi kokën tonë si pëlhurë meri-mange.

Dikush tha të bënim në kooperativë nga gjashtë-dhjetë ditë pune. Një shok i presidiumit tundi ko-kën në shenjë aprovimi.

Veç kur u ngritën ata të rinjtë që ju drejtu-an presidiumit të mbledhjes e atij që foli.

— Ne, shokë, mendojmë të bëjmë jo gjashtëdhjetë a shtatëdhjetë, por shtatëdhjetë e pesë gjer në tetëdhjetë ditë pune në kooperativë, me qëllim që atje të mos rrimë duarlidhur. Gjithashtu duke tejkaluar normën gjatë ngricave të dimrit, japim shembullin personal.

Unë fërkova duart, u ngrita dhe fola me entuziazëm:

— Po, shokë! Kjo është një inisiativë e mirë. Veç kësaj edhe ne nuk do të kemi një diferencë të madh nga paga mujore që merrnim gjatë muajve të fushatave; kurse, po të shtohen ditët e punës, do të lodhemi më tepër, por nga ana tjetër do të rriten të ardhurat tona.

Mirëpo, pa e mbaruar akoma fjalën, u ngrit një i ri tjetër:

— Ti, Fadil, mendon tamam si mikroborgjez — tha ai me nervozizëm. — Këto që thua ti nuk i kanë hije klasës punëtore.

Mbeta në këmbë i hutuar. Në sallë nuk ndihej asnjë zhurmë, ndërsa fytyrat e shokëve ishin kthyer drejt meje.

— Po, po, mirë e pat Inajeti — u hodh e tha një mekanik i shëndoshë. — S'na kanë lezet këto që thotë ky. More shoku Fadil, — m'u drejtua mua — a i ke lexuar materialet dhe vendimet e fundit të partisë? Lexoji mirë, lum miku, se vetëm atëhere do të dish ta rregullosh gjuhën e të mos flasësh përgjumësh.

— Të bëj autokritikë!

— T'ja hapë zemrën kolektivit si revolucionar i vërtetë.

Dridhesha më keq se sot. Palë-palë më vinin djersët e ftohta. E ndjeva thellë të keqen. Ngrita dy

duart përpjetë si fajtor përpara gjykimit të masës dhe thashë:

— Shokë! E bëra gabimin... A më falni?

Sytë më qenë njomur dhe gjithshka në këndin e kuq më dukej e kuqe, edhe mbulesa e tryezës, edhe pankartat, edhe fotoekspozitat e vëna nëpër mure.

— Ta falim, ta falim — murmuriti salla. Fytyrat e shokëve qenë zbutur. Kur u ula, njëri më zgjati një cigare, ndërsa tjetri, në krah, ndezi shkrepën.

Pastaj u ngrit kryetari. Në zërin e tij ndiheshin disa nota të gëzuara. Ai tha këto fjalë:

— Para se ta mbyllim, ta vendosim, shokë. Unë mendoj e besoj se edhe shokët janë dakord të vendosim që kooperativat bujqësore të mos na i paguajnë të gjitha ditët e punës. Me të vërtetë se neve, gjatë dimrit, na jepet një pagë bazë më e ulët se rroga që marrim kur punojmë në fushë, por, duke marrë tërë llogarinë e ditëve të punës që do të bëjmë në kooperativë plus pagën, shpërblimi ynë do të jetë më i madh edhe se sa kur punojmë me maqineritë. Pra, shokë, ne, si klasë punëtore, të japim shembullin personal dhe gjysmat e ditëve të punës të çdonjerit të kalojnë në dobi të kooperativës. Ta vëmë në votë, pra...

Shpërthyen duartrokitjet dhe ne e pranuan me gjithë zemër.

Por ama ai dush i mirë që hëngra, s'më harrohet.»

Po binte një mbrëmje e ftohtë dhe e gjatë dimri.

Traktori në duart e Fadilit lëviz dhe manovron me shpejtësi. Dëgjohet vetëm zhurma e tij. Maqina e hekurt s'do t'ja dijë për asgjë, ajo punon pa ndaluar. Ruspa e saj e madhe futet në borë dhe e hedh në anë. Zinxhirët janë mbushur me borën që ka ngrirë dhe është rrezik që traktori të rrëshqasë dhe të mbetet diku. Fadili nganjëherë lë kabinën dhe, me një çelës të madh, u bie zinxhirëve. Copat e akullit shkëputen si peta sheqeri.

Rruga filloi të zbriste, Traktoristi kishte ngulur sytë përpara dhe shikonte me vëmendje. Rruga ishte gjithë kthesa, gjithë zigzage. Këtu ishte vështirë të punohej. E ja, befas, një zhurmë e mbytur erdhi drejt Fadilit. Buçimat e traktorit humbin në të. Përpara s'duket gjë. Zhurma sa vjen e shtohet. Ajo duket si gurgullima e rrëmbyer e ujërave të borës, që shkrin në prak të pranverës. Ai hapi më tepër sytë dhe ja nguli errësirës. E kuptoi se ku ndodhej. Rruga gjarpëronte e lakonte në një shpat mali. Shkëmbinjtë e lëmuar e të thepisur, që ngriheshin lart, ishin ngarkuar aq shumë me borë, saqë të dukej sikur nga çasti në çast masa e bardhë... do të shembej e... do të binte. Krepat e mprehtë qëndronin si gjemba të ngulur në zemrën e gurit e të rrinin mbi kokë kur udhëtoje. Në anën tjetër të rrugës, ishte greminë. Gremina zbritte thikë njëqind metra poshtë, teksa, në fund, në shtratin shkëmbor të fryrë e të mbushur nga rreshjet e bora, gumëzhinte një lumë. Në anën tjetër të lu-

mit, përsëri ngriheshin male të larta, majat e të cilave sikur shponin qiellin.

Edhe në kohë të thatë, shoferët e ngadalësojnë shpejtësinë, se në kthesat e dendura të merren mendtë duke pasur parasysh se udha sa vete e zbret; ata e kanë shumë kujdes këtë rrugë, se një gabim i vogël, është fatal. Verës, në ujët e lumit vezullojnë rrezet e diellit dhe ngrihet lehtë veli i avujve. Të ngjan se lumi merr frymë më gjithë trupin. Tani ai sikur ishte mbledhur nën vete dhe buçiste.

Filloi edhe një borë e dendur me erë. Të ftohët të ngrin trupin. Fadili shtrëngon fort me duar levat e drejtimit. Me kujdesin më të madh, bën çdo lëvizje. Përpara, borë e madhe, sipër male të larta, poshtë humnera, kurse përreth natë, stuhi, përcëllimë. Në këtë errësi të thellë lumi gjëmon i turbullt, mbyturazi. Zhurma e tij futet gjer në kabinë brenda. Duhet kujdes! Kujdes, se lëvizja më e vogël e gabuar të çon në humnerë! Fadili shikon gjer ku i arrijnë dritat traktorit; katër metra më tutje ato humbin në një sfond të errët e të frikshëm. Ai është i vetëm në mes të errësirës së thellë të natës.

«Po shokët ç'bëjnë?» mendoi sakaq me vete.

Ndali traktorin dhe doli. Pas tij nuk shihej njeri. Ai vështroi më me ngulm dhe diçka dalloi. Larg, ku fillonte hyrja e asaj gryke, si dy shkëndija të vogla shquheshin dy drita. Ishte Qazimi. Spirua s'dukej gjëkund. Pa përsëri greminën, dëgjoi zhurmën e lumit, malet që i rrinin pezull mbi kokë.

«Po sikur të bie në greminë? S'do të më gjenet nishani. T'i pres shokët dhe të vazhdoj me ta? Ata janë larg, unë këtu vetëm. Ç'do të kujtojnë pastaj? Do të më quajnë ndoshta frikacak. Jo, jo,

s'bën kështu, Fadil. Jepi, jepi traktorit! Qazimi, shoku yt, e ka më të vështirë. Ti e largon borën pak në anë, kurse ai e shtyn mirë që ta zgjerojë rrugën. Ai e ka më të vështirë. Atëhere të pres shokun, të eci bashkë me të dhe të mos e lejoj të bëjë lëvizje të gabuara! Ke përparuar mjaft dhe kërkon të ndalesh, se s'ta mban. Ec përpara! Ec dhe ki kujdes! Mundohu ta hapësh ti, vetë, sa më shumë rrugën, që shokët të jenë më të sigurt. Tani shoku është larg, kurse ti ke frikë për vete».

— E kur kam pasur frikë që të kem sot? — pyeti me zë të lartë.

— Atëhere? Ç'pret? — ju duk se ja ktheu traktori me buçimat e tij të prera: drëk-drëk-drëk!..»

Fadili hyri brenda, shkeli me nervozizëm marshet dhe, duke mposhtur një frikë të vogël, u nis. Kthesat vijnë përpara njëra pas tjetrës. Ai ngjeshet mirë pas levave të drejtimit dhe shikon përpara.

Ngrica ka shtrënguar shumë. Natyra duket e kristalizuar, dhe nuk merr frymë nën barrën e borës. Këmbët nuk i ndjen. Në gishtërinj, poshtë thonjeve, i bëhet se i kanë futur gjilpëra të panumërta që e shpojnë orë e çast. Gjunjët i janë bërë akull e i dridhen. Era që fryn dhe bora që bie kanë mbushur qoshet e boshllëqet e s'duket asnjë cak. Vendi, në këtë bardhësi lodhëse, duket i rrafshët. «Nga t'ja mbaj?» Fadili lë traktorin. Zbret dhe fillon të kontrollojë përreth. Për të gjetur drejtimin e rrugës, i duhet një kohë. Gjurmët atje kryqëzohen e rrethohen me njëra-tjetrën gjersa ai e kupton se nga duhet të shkojë. Ngjitu në traktor e zbrit. Nuk e dinte as vetë sa herë e bëri këtë. Balli ju njom nga djersa. Merrte frymë me zor.

Ecën. Dëgjon zhurmën e një traktori tjetër. Shokët janë afruar. Herë pas here hedh dritat nëpër hapësirë për të kontrolluar vendin dhe gjen drejtimin. Do të gjejë urën para se t'i avitet për të mos rrëshqitur. Ajo ndodhet pas një kthese të fortë. Lëviz dhe me vëmendjen më të madhe ndjek çdo gjë. Të ftohtët sa vjen e shtohet. Bën veshët katër. Zhurma drithëruese e lumit e ndjek gjithmonë. Dritat shtrihen si fasha mbi borë. Kthesa. U duk edhe ura.

XII

Traktoristi lëvizi marshin dhe e ngadalësoi shpejtësinë. Qazimin e kishte katër-pesë metra larg. Në këtë distancë ishte edhe Spirua nga traktori i dytë. Lumi gjëmonte me rrëmbim, shfrynte e përplasej në shkëmbinjtë pranë. Tufat e rrezeve të dritave të traktorëve zbuluan urën e drunjte. Ajo gjen-dej disa hapa larg.

Qazimi i bënte shenjë që të ndalej. Inxhinieri, që kishte zbritur, i thirri:

— Mbaje! — dhe, pa e pasur mendjen aty, i kërkoi një cigare. Pastaj bërtiti e tha: — Si dreqin m'u mbaruan e ju nuk e pini asnjëri!

Era, që fishkëllen në vesh, të ftohtët që kërcet dhëmbët, errësira pus që turret nga të katër anët, padashur i bën t'i shkojnë të ngjethura në trup.

— Kjo urë, shokë, na ka dalë përpara si barrikadë, apo... si çiban i keq — tha inxhinieri.

— Ura është e keqe — tha Qazimi duke tundur kokën.

— Aty e kam hallin edhe unë. Është shumë e ngushtë dreqja!

— E ngushtë vërtet, por, po të manovrohet, edhe traktorët tanë kalojnë — tha Xhevdeti.

— Si nuk kalojnë, — e aprovoi Fadili — kur aty shkon çdo lloj automjeti.

— Vemi ta shohim një herë, shokë — tha inxhinieri dhe, papritur përgjegje, bëri përpara.

E çanë borën dhe ju afruan urës. Zbritën me radhë pranë saj. Duke e mbajtur zinxhirin te shoku-shoku, ata kontrolluan këmbët e drunjta. Inxhinieri mati me gishtërinj perimetrin e trarëve, që ishin vënë si këmbë.

Sipër hapën me duar borën dhe gjetën akull, një akull të trashë që s'e thyente as çelësi i madh. Kaluan anash dhe mundën të shihnin traversat. Inxhinieri ndezi elektrikun e dorës dhe arriti t'i numëronte që poshtë. Ai, herë pas here, me dorë të dredhur, mbante shënime në blok. Kur menduan se vërejtën gjithshka me imtësi në atë urë të drunjtë, u kthyen.

— E, shokë? Si thoni ju? — dhe inxhinieri nisi të bënte një llogaritje të vogël.

— Trarët kanë ngrirë, por telashet i ka akulli nën borë. Se ura është shumë e ngushtë e mjafton pakëz një devijim i vogël që të thyesh zverkun — tha Qazimi.

— Çfarë thonë llogaritjet tuaja, inxhinier? — pyeti Spirua.

— Si të them? S'e përcaktoj dot me saktësi. Hem kalohet, hem s'kalohet — tha ai duke shikuar

në blok. — S'e di, për nder. Për të pasur, ka shumë rrezik.

— Unë them se duhet të kalojmë — tha i vrejtur Fadili.

— E di ç'të bëjmë? Ndezim një zjarr e rrimë këtu dhe, kur të gdhijë, shohim e bëjrnë. Në mëngjez heqim borën dhe thyejmë akullin — tha Qazimi.

— Ja një mendim origjinal — shtoi me ironi Xhevdeti. — Unë jam me Fadilin.

— Pse, a kështu do të presim? Mos ndoshta mendoni se do të na bjerë nga qielli ndonjë urë me rrota? — shfryu Fadili pakëz me inat.

— Po ti, Spiro, si thua?

— Si të thoni ju të gjithë. Unë s'ndahem nga ju.

— Po a s'e kupton ti se duhet të kalojmë? — e ndërpreu Fadili me nervozizëm. — Këtu s'ka si të thoni ju; duhet të vendosësh vetë.

Inxhinieri, që shkante e vinte, tha me zë të plotë:

— Ta shohim edhe një herë urën. Ta matim.

— Ti, inxhinier, mate sa herë të duash... Më falni. Unë pc nisem.

— Fadil, do të vij edhe unë — tha Xhevdeti dhe kërceu nga ana tjetër e u ngjit në kabinë.

Inxhinieri, Qazimi e Spirua hapën rrugën dhe kaluan në njërën anë. Kur arritën buzë urës, Fadili dhe Xhevdeti zbritën. Të kapur dorë për dorë, ata përshkuan në këmbë tërë sipërfaqen e urës, gjersa e matën me hapa. Pastaj Fadili hipi dhe nisi të përparonte ngadalë me traktor. Xhevdeti lëvizte si hije para dritareve të maqinës së hekurit, hapte krahët, i bërtiste, se ishte shumë në

anë e herë-herë fundosej e rrëzohej në borë, në ata metra të paktë të asaj ure të drunjtë.

Si kaloi matanë dhe doli nga traktori, Fadili, duke i dhënë dorën Xhevdetit, pa inxhinierin që e kishte ndjekur nga prapa hap pas hapi. Tani e kuptoi se përse i dukej se dëgjonte dy zëra kur i thërriste Xhevdetit.

— Bravo! — s'u përmbajt inxhinieri, por, pasi e kuptoi që e shkeli, ktheu kokën anash.

— Po shkoj ta nxjerr unë traktorin e Qazimit e me radhë — shtoi pas pak ai e u nis për te dy traktoristët e tjerë. Mirëpo ata vunë re se traktori i Qazimit dhe ai i Spiros po lëviznin drejt tyre.

Si kaluan urën, Xhevdeti qëndroi e priti shokun. Duke zbritur, Fadili i shtrëngoi fort krahun me kuptim.

Ftohtë. Ajri ishte i akullt. Ai, si brisk, të priste grykën kur merrje frymë.

Fadilit i ishin skuqur duart dhe i digjnin. Gishtërinjtë i lëvizte me mundim. I fërkonte shpesh në kominoshe. Për një çast i ngroheshin, pastaj i mërdhinin më shumë. Edhe këmbët nuk i ndjente. I ishin mpirë gjunjët. Ndjehej shumë i lodhur.

Bora pështjellohej në ajër, pengonte shikimin dhe përplasej në xhamet e kabinës së traktorit.

XIII

Larg shquheshin disa drita elektrike. Ishte stacioni i dytë. Fadili shikoi me gëzim, ndërsa një ngazëllim i fortë e i brendshëm e pushtoi të tërin.

Pas pak, u zhduk edhe uturima e frikshme e lumit. Ai hodhi dritat e traktorit përreth dhe pa se ishte larguar nga ajo zonë. Traktori kërcente e gulçonte. Ai, si i pangopur, ecte përpara, fuste ruspën e madhe në borë, gëlltite sa donte e pastaj e flakte mënjanë. Duke luftuar sa majtas-djathtas, traktori hyri në rrugët e qendrës së lokalitetit. Disa banorëve të vonuar e që nxitonin, u qeshën fytyrat nga gëzimi dhe e përshëndetën me dorë. Të tjerë i folën:

— Erdhe! Shumë mirë!

— Të lumtë, për nder!

— Ja bëre si burrat!

Atij ju bë zemra mal e kjo sikur i dha krahë. Shkoi e u ul në një bufe-restorant. Kamerieri, që kishte dëgjuar e parë traktorin kur arriti, i erdhë pa u rehatuar mirë.

— Mirë mbrëmani, shok i dashur! Ç'dëshironi?

— Njatjeta! Hëm, po... unë pres edhe disa shokë. Megjithatë, më sillni një kafe.

Piu me etje kafënë.

Në ambientin e ngrohtë të lokalit, ku nga qoshja përhapëj nxehtësia e sobës, e ndjeu veten shumë mirë. Gishtërinjtë, nga temperatura krejt e ndryshme me atë të jashtmen, sikur nuk i bindeshin. Nëpërgjunjë, sikur ta kishte zënë korrenti, i shkonin të rrëqethura. U mbështet në karrige dhe i mbylli sytë përgjysmë.

Disa njerëz u futën me zhurmë brenda, ndërsa njëri thirri:

— Ja edhe Fadili ku qenka shtruar!

Ishin shokët e tij.

— Po inxhinieri ku është?

— Shkoi të lajmërojë qendrën.

Traktoristët u ulën dhe ja filluan një muhabeti të këndshëm. Erdhi edhe inxhinieri duke shkundur borën. Fytyra i shndriste nga gazi dhe, sipas zakonit, fërkonte duart.

— Lajmërova komitetin e partisë të rrethit. Në telefon doli vetë sekretari. Ai në emër të të gjithë rrethit na përgëzoi për punën që kemi bërë. Tani na mbetet edhe një kala. Këtë do ta marrim. Apo jo, shokë? — pyeti inxhinieri.

— A pimë nga një gotë, sa për t'u nxehur? — tha Spirua.

— Hej, kamerier! — thirri Fadili pa e mbaruar mirë ai fjalën.

Kamerieri erdhi menjëherë.

— Urdhëroni, shokë!

— Sillna nga një teke raki rrushi dhe pesë bërçolla. Si thoni, shokë?

— Dakord.

— Ta ngremë për traktorët! — propozoi i pari Fadili.

Pinin dhe hanin me shije. Të uritur, mbushnin gojën plot, bënin shaka e qeshnin.

— Një doli për Fadilin! — tha inxhinieri me seriozitet. — Për guximin e tij.

Te tryeza e tyre u afrua një burrë i shkurtër, me fytyrë të skuqur nga thëllimi i borës dhe me një çantë me rrip të gjatë pas shpine.

— Mos jeni ju ata traktoristët që hapni rrugën?

— Po. Pse, ç'ka ndodhur? — pyeti i merakosur inxhinieri që e nuhati se ishte postieri.

— Asgjë e keqe. Lajme të gëzuara. Kam një telegram. Tani e morën dhe unë e shpejtova t'ju sjell. — I rrahur në këto punë, ai foli rrëmbimthi për t'ua hequr shqetësimin që e kap njeriun, kur

troket natën porta e shikon në prak postierin. —
I drejtohet Qazimit.

— Mua! — tha traktoristi, i cili u kuptua nga toni i zërit se diçka pritte.

Ashtu i skuqur, ai hodhi një firmë dhe, me të shpejt e hapi. E përpiu me sy dhe, duke i shtrënguar dorën postierit, i thirri me zë të gëzuar kamerierit:

— Jepi një llokum nga unë!

U sheshua në karrige, nga gëzimi, ju qepën buzët e s'gjente fjalët që duhet të thoshte.

Shokët vështruan telegramin. Fadili e rrëmbeu dhe e lexoi me zë të lartë:

«Të lindi vajzë. Me jetë të gjatë. Familjen e ke shëndoshë e mirë.

Kolektivi i SMT-së»

— Të rrojë e me këmbë të mbarë! — thirrën ata njëzëri. Dhe ashtu si ishin, vërshuan drejt Qazimit.

Fadili u shtrëngua mirë me peliçe dhe nëpër thëllim u nis me vrap për te traktori. Kur u kthye, kishte në dorë mandolinën e tij, të cilën e mbante gjithmonë në kabinë.

Ata qeshnin, bënë zhurmë e s'dinin si ta shprehnin gëzimin e përbashkët. Qazimit sikur i erdhën krahë. Asnjëri s'e ndjente lodhjen dhe pagjumësinë.

— Thirrja një herë këngës, o Fadil! — i tha Qazimi.

Fadili, si u kollit për të qeruar grykën ja mori këngës duke e shoqëruar me mandolinë. Fadili shfaqti gëzimin e jetës pas një ditë të lodhshme pune.

Mesnata që afruar e, megjithatë, personeli shër-

byes nuk e mbylli lokalin që të mos ua prishte atyre. Ata erdhën vonë dhe nuk duhej ta zgjatnin tepër, por njerëzit kanë gëzimet e tyre. Salla ishte boshatisur dhe vetëm tryeza e tyre ishte e zënë.

Kamerieri u solli llokumet e Qazimit dhe një pjatë me pasta.

— Me jetë të gjatë, o Qazim, e qofsh gjithmonë i lumtur! — e uruan shokët.

— Hej, Qazim, Qazim! Prandaj s'e hapje gojën rrugës, e ke pasur mendjen në tjetër vend! — filloi ta ngacmonte Fadili.

— Kam dëgjuar se diku në botë — tha inxhinieri — vajzat, gjer në moshën dymbëdhjetëvjeçare i quajnë «titi», që në gjuhën e atij vendi do të thotë lule, e vetëm pas kësaj moshe u vënë emrat.

Fadili u shkeli syrin shokëve dhe mandej ju drejtua Qazimit.

— E pse u preke aq fort, ore, apo s'të pëlqeu se është vajzë?

— Akoma nuk i paske hequr këto mendime prapanike ti, shoku Qazim? — e mprehu më tepër thumbin e shakasë Spirua. Mirëpo, ngaqë nuk e mbajti dot veten, ja krisi një gazi me potere.

— Talluni, talluni, shokë, por mua aq më bën tani. Ja, tek po ju flas me dorë në zemër, se, kur je në këtë gjendjen time, edhe po të duash, nuk fshen dot gjë. Të dyve, mua dhe gruas, nuk na kanë ngurënë meraku kurrë se çfarë do të lindte. Jo, për nder. Ne kemi bërë dhe njëfarë plani për fëmijën. Po të ishte djalë, do ta bëja traktorist, domethënë do t'i jepja zanatin e babait, — qeshi Qazimi kur tha fjalën e fundit — kurse vajzën, tornitore.

— Pas shqetësimeve që ke pasur, gëzohu, Qazim, gëzohu. Ta them unë. Edhe mua, kur m'u

shtrua gruaja në maternitet, vajta nja dhjetë herë në zyrën e kuadrit për të pyetur në telefon. Atë pasdite që lindi djalin nuk dija ç'të bëja. Shkoja ku shkoja dhe kthehesha e ngulesha para dritareve të dhomës së saj dhe rrija aty një orë. Dhe s'më bënin përshtypje fare shikimet e njerëzve — tregoi me sinqeritet Fadili.

— Ashtu është, i shqetësuar isha — tha Qazimi.
— Po tani të mendojmë emrin. Si do t'ja vëmë?

Këtu nisën diskutimet.

— E di çfarë? E gjeta! — tha inxhinieri. — Rrëmbeni nga një pastë në dorë dhe ngrehuni në këmbë.

Ata bënë si tha ai dhe, duke u zgjatur drejt tyre, inxhinieri shqiptoi rrokje-rrokje:

— Fi-to-re!

— Bravo! — shpërthyen të gjithë pa e kuptuar dhe duartrokiten. Pastaj qeshën me lot për kuptimin e dytë, me të cilin e përdornin këtë fjalë.

XIV

Xhevdeti dhe kuzhinieri, që u ngritën një orë më herët, kishin vënë të nxehej një kazan me ujë. Si fjetën pesë orë, Xhevdeti vajti e i zgjoi shokët. Ujët ishte gati dhe ata shkuan te traktorët.

Përsëri zhurmoi llamba e benzinës për të holluar vajin.

U ndezën motorët. I provuan në ishin në rregull.

Qazimit s'i rrihej në një vend. Shkonte sa të njëri traktor, te tjetri.

— Në një mëngjezore aty pranë, ashtu në këmbë, duke u përtypur shpejt e shpejt, pinë nga dy gota qumësht me pak bukë.

U nisën. Dy veta i përcollën me kalë. Traktoristët s'e ndjenë rrugën.

Po zbardhte. Dy kalorësit që i shoqëruan, u uruan rrugë të mbarë dhe u kthyen.

«Qazimi është më i lumturi sot, mendoj Fadili. Gruaja i lindi fëmijën e parë dhe e ka shëndoshë e mirë. Shumë bukur i tha ato fjalë mbrëmë. Vajzat e sotme vërtet kanë tjetër fat. . . Po në familjen time si janë? Agimi akoma nuk është ngritur, kurse Shkëndija ka ndezur sobën e bën gati mëngjezin. Kam frikë se mos më ftohet djali. Shkëndija dimër e verë e detyron atë të ndreqë shtratin e të presë dru të thata për zjarrin. Njëqind herë i kam thënë të ma ruajë djalin. Se ajo grua është e asaj i përket të bëjë punët e shtëpisë.»

Kokën e ndjeu të rënduar. Mendjen ja përshkonin mendime të ndryshme, të cilat copa-copa, si pjesë të një mozaiku të lashtë, ndryshonin nga ngjyra, por kishin një bosht, një qëllim, shprehnin një ide. Dhe kjo kishte të bënte me ato skutat e thella të ndër-gjegjës. Kështu rrallë mund të shohësh se ç'ke atje brenda. Këtë njeriu e bën kur është vetëm ballë për ballë me konceptet e tij, atëhere kur duhet të përmbushë një detyrë të vështirë, kur i qëllon të takojë në shembuj të lartë që e detyrojnë dashje pa dashje të analizojë veten me imtësi. Ai vë në balancë veten dhe rrethin familjar me kërkesat e kohës.

«Sot ta mbledhin gratë». Ju kujtua se njëherë kishte takuar në mes të ngricës, acarit dhe akullit të

dimrit dy gra që po shkonin në qytet të zgjidhnin një padrejtësi që u kishin bërë ata të këshillit popullor të fshatit. Ishin ngritur të bijat e botës nga ana e anës për në qytet. Kishin çarë borën, kishin kaluar nëpër akull, nuk i ishin trembur erës! «Duket si një gjë e vogël, por... hëm, është një veprim ky që hajde, more, hajde, të lot tepelekun! Në përgjithësi, janë pak të nxituara femrat. S'ka as lezet kjo, menjëherë e në komitetin ekzekutiv të rrethit. Po Shkëndija a do ta kishte bërë këtë?»

U mendua një grimë e qeshi pa shije.

«Jo. S'do ta bënte. Kështu është gatuar ajo. Shikimi i saj nuk shkon gjer atje. Ajo di veç punët e shtëpisë. Bile edhe «Shqiptaren e re» ja lexoj unë, kurse ajo shikon për një kohë të gjatë vetëm fotografitë. Në shtëpi sapo vjen, përvesh llërët. Lan e fshin gjithë ditën. Megjithatë shokët e punës thonë fjalë të mira për të.

— Ka gra të shkathëta Shqipëria e ato s'janë si gruaja ime — mendoj ai përsëri për Shkëndijen. — E njoh mirë gruan time unë. Por edhe më të zonjën nuk e dua të jetë. E shkathët është, punëtore po. Më gatuan, më mban djalin. Vij nga puna e më pret me buzë në gaz. Nuk i pëlqen nganjëherë ajo era e naftës që mbart kudo me vete, por unë nuk e pyes për këtë gjë.»

Fadili luajti levën e drejtimit, por traktori qëndroi në vend e s'ju bind. Ai shkeli marshet, i dha gaz, por qe e pamundur.

Nga xhamet e kabinës bora dukej sikur binte litarë-litarë.

Shfryu nëpër dhëmbë me inat. Hapi portëzën me tërsëllëm e doli. Kur vuri këmbët e mpira në to-

kë, e ndjeu prapë kokën të rënduar dhe i rrihnin e i buçisnin tëmthat. Kishte dhimbje.

Jashtë binte shushec. Shusheci është një përzierje e ngrirë bore dhe shiu. Ai derdhet me kokrriza të lagëta, shushurin e ja bën «shshsh». Era e merrte me vete dhe ja përplaste Fadilit. Ai ndjeu t'i lagej fytyra dhe pjesët e zbuluara të kokës.

— E dreqin! — u përtyp duke i ardhur rrotull traktorit.

«Ky zanati im gjatë gjithë kohës të lë jashtë. Eh, dimri, dimri! Si ka thënë ai i motit: «Unë nuk qava verën të qaj babën», dimrin s'e ka vënë në hesap fare». Ai hapi radiatorin. «Phu! pështyu. «Po ku e ke belanë, xhanëm? More, more, s'jam në vete fare. Fillove të matufepsesh, Fadil», tha me vete.

Ja kishte vënë veshin zhurmës së traktorit dhe dalloj në çast se ai nuk nxirrte më ato zhurmat e njëjta e të zakonshme, zhurmat e tij ishin si gërzhimat e një nevrasteniku. E kuptoi se traktori punonte me tre pistona. «Mos ndoshta pistonit të katërt nuk i shkon nafta?» Ishin blouat e tuat e naftës e injektorit nuk furnizohej. Injektori nuk i jepte naftë motorit. Ndaj motori gërhiste e dridhej keq. Traktoristi hoqi injektorin. «Duhet të ketë ngrirë akull ose është mbushur me mbeturinat e naftës». E shkundi jashtë dhe prej tij ranë copërat e akullit. E fshiu edhe me leckë për t'u siguruar mirë. Vuri injektorin.

Atij i shkoi një e rrënqethur nëpër trup, që nga koka në këmbë. «Zanati i traktoristit», mendoi. Ndjeu t'i hynte shusheci përsëri në qafë, «Phu!» dhe

shau rëndë. Hipi. Tërhoqi marshin. Ruspa ishte bërë përsëri e fuqishme dhe sulej drejt borës. Nafta kalonte.

• • •

«A janë kënaqur djali dhe shokët e tij me ato që u bleva? Besoj se nuk u lashë gjë mangut. Po t'i kishte blerë Shkëndija, me siguri që diçka do të mungonte. S'e lija unë për ditëlindjen e djalit të dilte në pazar ajo. Jo, or, jo! Jam gjallë vetë».

«Shkëndija!» Përse i kujtohej në këtë kohë kaq shpesh e shoqja.

Pastaj mendimet përsëri e futën në rrjedhën e tyre e i ngjante sikur ishte kredhur në një vorbull, e cila e sillte përreth si ndonjë rrotullame. Traktoristi u mundua të shkëputej prej kësaj vorbulle e të dilte jashtë, të shpëtonte prej kësaj shoshitjeje që po bënte me vete, por s'arrinte gjer aty... U detyrua të përqëndrohej në mendimet e tij që e shqetësonin dhe kështu vazhdoi me gjakftohtësi analizën e tyre.

Atij ju kujtuan përsëri dasma në rrugë, diskutimi në mbledhjen e bashkimeve profesionale. Fitorja, vajza e Qazimit.

«Shkëndija? Ç'lidhje kishte ajo me tërë këto të tjera në qytet? Ajo mbaroi qysh në fejesë kursin e infermierëve dhe hyri në punë. E përse të shkente në Tiranë Shkëndija e të specializohej më tej, kur e kishte zanatin. Ai kurs për Shkëndijën ishte i mjaftueshëm. Duheshin pasur parasysh shtëpia, djali, unë. A thua vallë se nuk është e kënaqur ajo me ato që ka?»

Atij ju kujtua se kurrë s'e kishte gjykuar të shoqen nën dritën e mendimit të të gjitha grave,

të rejave, të diskutimit në rrugë, të gëzimit të Qazimit për vajzën e tij. A s'mund të shkonte përpara e shoqja? A s'do ta kishte kryer kursin e specializimit me sukses? Po për ditëlindjen e Agimit a nuk do të kishte blerë ushqimet e nevojshme? A? . Ç'i mungonte asaj për t'i bërë të gjitha këto? Dhe ju bë sikur e pa të shoqen në kohën e vajzërisë, të gjallë, të shkathët, aq të zonjën! Ai për të gjitha këto e pëlqeu dhe e mori. Ju duk vetja sikur që në një pyll të mbuluar me gjethe të kalbura e me fletë të verdha. Mjaftonte të pastronte gjethet, që tani dukej se po i mblidhte me krehër të gjatë dhe bari do të harlisej përsëri i shëndetshëm dhe i ri.

Fadili ndjeu t'i ngrinte gjaku e t'i skuqeshin veshët. Ju përfytyruan edhe një herë ngjarjet dhe mendimet e gjeratëhershme që kur ishte nisur nga qyteti për të hapur rrugën. Pëshpëriti: «Ke mendime prapanike për gruan, Fadil Shpanaj!». Ndërgjegjja ishte vënë në shenjë prej kohësh. «Apo mos jam konservator? Përsë mendoj vallë se gratë e tjerë janë të zonjat të bëjnë çdo gjë, kurse time shoqe e pengojnë shumë gjëra?

Ë ndjeu se pati një boshllëk në vetëvete. Ju duk se hoqi me forcë duke bërë: «zhap!» nga brendësia një mish të huaj, si shirit derri mbështjellë e bërë kutulaç, ashtu siç heqim me forcë nga një puçërr e majisur dhe e fryrë shtratin e ngurtësuar të qelbit. Por vetëm kaq. Ndryshimet në botëkuptim nuk ndodhin asnjëherë me zhurmë!

Ai ishte zhytur në vetëvete dhe nuk e pa shkëmbin që i doli si pykë përpara. Sa nuk u përplas me të. Luajti levën me shpejtësi. Ndonëse me vonësë, ai e mori edhe këtë kthesë mirë.

Dita do të qe e bukur. Borë nuk do të binte. Qielli qe çuditërisht i kthjellët, i qelqtë, me një disk dielli. Dita ishte jashtëzakonisht e ndritshme dhe e ftohtë. Në zenit endeshin disa re të holla. Në dimër shpesh, pas ditëve të këqija me borë, koha ndryshon. Por kështu ajo të gënjen. Kur bie borë, të ftohtët ulet. Ngjan se çdo gjë nis të trishtohet e ky trishtim është zbutje. Kur në qiell del dielli, atëhere të ftohtët është më i madh, shtohet. Ajri ndehet e nuk lëviz. Ai të shpon e të ngrin. Në këtë kohë metalet të ngjiten për dore, kurserrezet e diellit të mbushin me gëzim e të duket sikur po vjen pranvera. Por gëzimi është i rremë, sepse kjo të ndodh, po të jesh edhe në mes të dimrit. Iluzion!

Traktorët përparojnë. Pas tyre mbetet rruga e hapur.

Pyje. Pyje pa fund, pa anë. Drunj të gjatë e të drejtë. Heshtje e thellë. Ndonjë pemë gati sa nuk thyhet nga pesha e borës. Një masë bore rrëshqet dhe dega ngrihet me një krismë të thatë e të mprehtë.

Traktorët janë larguar nga njëri-tjetri. Pylli mbaron. Përpara, kudo, shtrihet sa të zë syri, një fushë e bardhë, e zhveshur, e lëmuar nga erërat.

Nga pylli dëgjohet një angullimë e largët si një jehonë apo zhurmë nga lashtësia. Era e zgjatte angullimën, ndërsa bora e bardhë e përhapte dhe e përçonte nga të katër anët. Instinktivisht Fadili kap çelësin e madh. «Ulërijnë kopetë e ujçërve», mendon.

Të ftohtët sa vente e shtohet. Ai vërshonte nga të katër anët dhe përplasej në trupin e traktoristit. Duket sikur buronte nga toka. E vinte duke u shtuar gjithmonë. Fadilit fytyra i ishte skuqur. Vende-vende kishte filluar t'i nxihej. Ulet dhe merr një shuk bore. Fërkon fort me të fytyrën. Koka i lehtësohet dhe veshët i buçasin më pak. Merr edhe një shuk tjetër, e thërmon dhe, me të dy duart, fërkohet përsëri. Por edhe duart nuk i binden më. Ato i kanë plasur, veçse tani nuk i djegin. Të ftohtët e ka kaluar këtë shkallë. Shtrëngon me sa fuqi ka gishtat në grusht derisa i kërcasin kockat.

Fillon të fryjë. Këtu, kur era fillon e fryn me furi, të ngre peshë përpjetë. Prandaj, si rrallë në ndonjë vend tjetër, shtëpitë kanë nga dy palë xhame për shkak të erës. Era të ndal në vend e të pret frymën. Ajo fryn bashkë me borën e s'të lë të bësh dy hapa.

Ruspa futet thell, në borë. Era lëshohet si e tërbuar me fishkëllima të mprehta dhe e ngre borën duke e përplatur në xhamet e traktorit. E ngre lart pendë dhe e ngjesh rrëzë gurëve e pemëve togje-togje. Natyrën, acarin e të ftohtët Fadili i shëmbëllen me një përbindsh gjigant të bardhë e me gojë të madhe, që ka zaptuar vendin. Mbyll përgjysmë sytë e i duket sikur e vështron përbindshin drejt në fytyrë pa përpëlitur qepallat. Lëviz me kujdes levat. Traktori ecën më shpejt përpara. Traktoristit tani i djegin më fort këmbët. Gishtat, si t'i ketë të futura në allçi, nuk i lëviz dot. Prej tyre i vjen një dhembje therëse dhe e paduruar. Godet me grusht gjunjët. Për të shkelur marshet, rëndon me tërë peshën e trupit, duke shtrënguar dhëmbët. Kjo e mundon dhe e lodh.

Ai e hoqi traktorin nga marshi dhe i shkeli gazin deri në fund. U ngjesh pas motorit dhe nisi të ngrohej. Filloi ta ndjente veten më mirë. Veçse ajri i kabinës vazhdonte të ishte i ftohtë. Gjymtyrët mundi t'i lëvizte. Një rrymë e ngrohtë, që i ngjitej nga gjoksi, i kalonte nëpër kurriz dhe e bënte që të rrëqethej. Uria, që ishte platitur prej të ftohtit, sikur ngriti krye. Në stomak ndjeu një zbrazëtirë të madhe. Ngadalë u përhap një erë mishi. Kjo i gudulisi flegrat. Era vinte prej mishit që po shkrihej mbi motor.

Fadili e mori me gëzim pakon dhe nxori racionin e drekës. Bukën nuk e ngau me dorë. Përtypi në heshtje një thelë mish dhe patate të skuqura. Mishi kishte shijen e mirë të konservave. Ju hap oreksi. E hëngri të gjithë mishin. Edhe patatat i mbaroi. Për çudi pastaj po i vinte gjumë. Kishte qejf të shtrihej kudo dhe vetëm të flinte. «Mos më vjen vallë nga gjumi i kursyer i këtyre dy netve, apo nga diçka tjetër? Nuk e di. Vetëm më flihet. Por nuk mundem!...»

Ngrica shtohet gjithnjë. Për një çast ai mendoi të ndalej. Por kështu koha zgjatej. Çdo minutë që kalonte kushtonte shumë. Ishte fjala për detyrën e ngarkuar, e cila duhej të plotësohej sa më parë.

Era përplasej pas xhameve. Një ftohtësirë e padukshme kishte filluar t'i hynte në kraharor. Prej asaj kraharori ju duk si një plloçë e akullt guri. Bora lëvizte e bëhej togje. Këmbët s'i bindeshin. Fadili punonte parreshtur. Dita po ikte. Ja edhe miniera. Qyteti dukej sikur ishte mbledhur në vetëvete. Në rrugë rrallë lëvizte ndonjë njeri.

Një ndjenjë e ëmbël e fortë e rrëmbeu traktoristin: «Qëllimi i caktuar pothuajse u arrit: Më së

fundi, do të kem mundësi të pushoj». Pra, filloi të mendojë. Mendimet i vërshonin.

«Si të mbaroj, do ta fut traktorin nën strehën e metalpunuesve, se atje është i sigurt. Me një frymë do të shkoj në klub e do të prehem pranë sobës. Ah, sikur të ngrohesh edhe një herë, ashtu siç dua unë, mirë e mirë! Prej këtej në hotel. Atje, së bashku me shokët do të flemë sa të duam, ndoshta gjer nesër në drekë...»

XVI

Nga lart po vinte poshtë drejt rrugës një grup njerëzish. Në krahë të gjithë kishin nga një lopatë. «Ku po shkojnë këta» mendoi Fadili. Ndoshta po i ndihmojnë njëri-tjetrit që të pastrojnë çatitë e shtëpive nga bora, sepse ka shumë rrezik që ato të shemben nën peshën e saj».

Në të djathtë të rrugës u shfaq një lapidar.

Fadilit, sa e pa, ju ndrydh zemra. Psherëtiu thellë dhe ja nguli sytë përsëri. Para syve ju përfytyra si e gjallë fytyra e vërtetë e shokut të tij, Halimit.

«...Në fytyrë kishte përherë një buzëqeshje. Një buzëqeshje të ngrohtë e plot dashuri.

Traktori i tij s'pushoi as natën! Lodhjen s'ndjeu gjer nga mesi i natës. Atëhere, menjëherë, ju shuan dritat. Ç'të bënte? Mori fenerin në mezhde. Pa se mos kishte ndonjë difekt aparatura e kabinës.

Asgjë. Hipi mbi zinxhirët dhe e vari fenerin në ganxhën pranë. Në dritën e zbetë të tij, ai zuri të kontrollonte dinamon. Rrëshqitja e madhe e tokës ishte e shpejtë. Traktori ra dhe e zuri përfund edhe traktoristin.»

Ishte kujtimi i shokut që rronte gjallë te të gjithë traktoristët.

«Eh, ajo kohë e keqe që s'do të më hiqet kurrë nga mendja. Shiu derdhej çurkë dhe era e përplaste nga të katër anët. Terreni ishte mjaft i vështirë, por Halimi s'tha as edhe një fjalë, kur na caktuan atje. Sikur të mos kishte pasur shi, toka nuk do të rrëshqiste. Ujërat e turbullta rridhnin dhe gërryenin tokën.»

Fadili lexoi me zë të lartë e pak të ngjirur fjalët e shkruara në katrorin e pllakës «Gusht... në krye të detyrës... ra... dëshmor i punës socialiste».

Profesioni i parë i Halimit kishte qenë ai i saldatorit. Fadili e kish dëgjuar t'i fliste për dritën e bardhë verbuese që lëshonte saldatriçja, kur ndeshte në metale e i shkrinte ato. Mirëpo atë e tërhiqte edhe fusha, njerëzit. Dëshironte të ndodhej përherë në mes të njerëzve e t'u ndihmonte. Ndaj në kooperativat bujqësore, ku kish punuar, s'kishte njeri që të mos e kish njohur.

Fadili qëndronte pranë mermerit të kuq, të akullt e mendonte «E unë s'ja gjeja dot fillin pse s'punonte traktori. Shkova në SMT dhe takova inxhinierin. Por ai s'kish ç'ti bënte prej aty. Na mblodhi në zyrë dhe kërkoi mendim. Folëm. Halimi tha të bëja regjistrimin e valvulave, por unë kisha vitin e parë e s'kisha eksperiencë. Atëhere tha:

— Ju, shoku inxhinier, keni punë këtu, se jemi në valën e fushatës, më lejoni të shkoj vetë?

Xhevahir njeri. Erdhi. Udhëtuam atë ditë katër-
orë më këmbë. La traktorin e tij, dhe, duke hum-
bur dy ditë pune, Halimi erdhi të më ndihmonte. Ai
e gjeti difektin, më mësoi edhe mua si rregullohej
dhe iku në atë zheg që të përvëlonte. A harro-
het kjo?»

XVII

Fadili e drejton ruspën në borë, e flak në anë
dhe vazhdon. Ruspa lëviz bosh.

Aty mbaronte kufiri i borës.

Rruga u hap. Ajo kalonte përmes qytetit dhe
humbte ku bashkoheshin dy malet.

Ai mori frymë thellë. Ndjeu një gëzim të brend-
shëm e të papërskruar, por edhe trupin të dër-
muar.

Era ngrinte dredha bore që frushullonin duke
fluturuar si pluhur sheqeri.

Afër maqinës së hekurt erdhi grupi i njerëzve
që zbritën nga lart. Kishin veshur çizme me qafa
shumë të gjata, mushama në ngjyrë kafe të errët
dhe kokën e kishin mbuluar me kapuç me majë.
Ishin minatorët e kromit me lopata në krahë. Nga
goja u dilte avull. Ata e përshëndetën traktoristin.

— Për nga kështu, o burra? — i pyeti Fadili.

Ata mezi e dëgjuan zërin e tij.

— Përtej.

— Ç'hall keni në këtë të ftohtë? — Zëri i trak-
toristit ishte tepër i ngjirur dhe fjalët i dilnin zvarrë
nga gryka.

— Shiko atje, tek ajo rruga e dytë! — ja bëri njëri duke treguar me dorë.

Traktoristi hodhi vështrimin e lodhur. Diku, në mes të fushës pa mbarim të mbretërisë së bardhë, shqoi flakën e një zjarri dhe një tym të lehtë, që ngrihej ngadalë. Pranë tij, si të renditura me dorë, dalloheshin ca pika të murme. Traktoristi e kuptoi se ishin maqina. «Ç'taksirat kanë pasur që kanë mbetur aty?» mendoi. Të shkretët shoferë! Ndoshta s'janë mësuar me borën. Duhet të jenë strukur përrreth zjarrit, se të ftohtët në këtë fushë të shpon si turjelë tejmbanë».

— Po ç'kërkojnë në atë vend ato maqina? — pyeti Fadili. Trupin e ngrirë s'e ndjente më më e kishte të tijin, megjithëse qe shtrënguar pas motorit.

— Janë nja dhjetë «Skoda» të kromit. Dje, duke ardhur për ngarkesë, mbetën të blokuara në borë. Rruga kryesore ishte mbushur plot para se të vije ti. Shoferët me maqinat e tyre duke dredhur njëra pas tjetrës, tek ajo rruga e dytë, e vjetra, me mendimin se era e kishte fshirë prej aty borën, mbetën. Bora u ka arritur gjer mbi gjysmën e gomave...

— Ju po shkoni t'u hapni rrugën? — pyeti ai duke e ndërprerë minatorin.

— Mbaruam tani turnin — u përgjegj një tjetër — dhe po shpejtojmë për atje.

— E sa kohë do t'ju duhet?

— Për nder, — u mendua tjetri — mjaft kohë duhet, se jemi edhe të lodhur.

— Jo, vetë s'kemi mundësi ta mbarojmë — shtoi shoku i tij. — Pas nesh do të vijë edhe turni tjetër.

— Po... do të duhen nja dymbëdhjetë orë — tha i pari që, si duket, ishte i menduar.

— Hajt, mirë u pafshim! — përsëritet të tjerët.

Borë! Përcëllimë!

Puna mbaroi. «Skodat» përpara.

«Rruga u hap, mendoi Fadili. Në klub është ngrohtë. Jashtë acar. Brenda soba kërcet sa mundet. Xhamat vishen me avull, me lulka. Unë do të jem aty rehat».

Mendja e lodhur i punoi përsëri në një pikë. Në fund të fundit, ndërgjegjja s'e lejonte për rrugë tjetër. Këtë e ndjeu thellë në vetëvete, atje ku syri s'depërton...

«Tani s'duhet menduar», tha me vete. E, si për t'u siguruar, ju kthye traktorit:

— A je i fortë? E çajmë dot edhe atë? Është penguar puna dhe nuk dihet me siguri kur do të fillojë. Pastaj, shoferët kanë të ftohtë.

— Drëk-drëk-drëk! Çë-çë-ça-ça-çë! Drëk-drëk!

— Ti duron, megjithëse detyra u plotësua! — Zëri i trashë dhe i ngjirur që i dilte prej kraharorit të tharë ju bë i lëngët.

Ju kujtua Fitorja e vogël e Qazimit. Mendoi shokët, familjen, djalin e tij. Hej, sa shpejt e mori malli për të! Ata të gjithë ishin aty me të në mend. A do të ishin thyer shokët? Po «Skodat»? Po kromi? Po minatorët?

«Skodat.» Kromi.»

Një forcë e madhe, që sikur i vinte nga toka, e pushtoi.

Ai hodhi sytë nga traktori. Pa të gjitha aparatet, levat, ndërsa motori u përgjegjjejë këtyre përkëdheljeve me buçimat e tij të pandërprera.

«Nuk mërdhin, hë? Përpara, pra! Të marrtë

Fadili të keqen!» uroi me zemër, se s'mundi të fliste.

E drejtoi traktorin përpara dhe shkeli gazin për t'i arritur minatorët.

— Shkoni në shtëpi. E pastroj unë për gjysëm orë — u tha minatorëve.

Ata deshën të kundërshtonin, por, kur panë se traktori u sul, ndaluan dhe thanë një zëri:

— Faleminderit! Faleminderit!

Traktoristi ka mbyllur sytë përgjysmë dhe pushton me të dy duart levat e drejtimit. Shton shpejtësinë e traktorit. Ngre e ul vetullat, po qepallat e rënduara përsëri i mbyllen. Ai përsëri me sforcime përpiqet t'i hapë. Këmbët nuk i ndjen.

Pasi mori kthesën, u ngjit në rrugën e dytë. Trashësia e borës ishte e madhe. Uli ruspën dhe filloi të pastronte rrugën. Tani gjithë vëmendjen e përqëndroi në këtë punë. Traktori lëkundet, rrotullohet menjëherë në vend, e ngjesh borën anash sa s'ka ku të vejë më dhe, me po atë shpejtësi, i drejtohet rrugës së mbuluar. Minutat kalojnë, por atij i duket se distanca s'ka të sosur.

VIII

Si një vizion i largët, i mbuluar nga mjegulla të lehta e të hirta, atij ju kujtua ndihmësi i tij.

«Ta kisha Lekën këtu! Do të punonim me radhë... gjersa të qe nevoja».

Dhe traktoristit ju duk sikur e kish aty pranë.

«Lekë, o Lekë! i gurgulloi zëri në grykë. Eja më zëvendëso!»

Zgjati dorën anash. Ajo mbeti e varur bosh në ajër.

«E, Leka!»

Traktori lëkundej si tundet trupi nën ritmin e valles.

«Leka e ka mendjen tani te fejesa. Është akoma në fshat. Po realizon zotimin e ditëve të punës në kooperativë.»

Traktori ecte tërë zhurmë.

«Po shtëpia e kulturës, që gjëmonte gjithë natën? Soba ndizej e bubullonte. Ne përvishnim krahet e, hopa në valle! Pa kur niste vallëzimi. E, si bëhej Leka që s'më ndahej! Më afronte gojën te veshi e më pëshpëriste:

— Fadil, a të shkoj ta marr atë vajzën me shaminë e lidhur nën gushë, që ka ulur kokën?

— Merr, more, cilën të duash!

— Mirë, mirë, ore, por po ta marr atë, a nuk do të më shikojnë mua të gjithë?

Dukej se e kishte zënë qymyri. Ai shkante ngadalë tek ajo dhe të dy mezi i lëviznin këmbët.

— Dua të bisedoj me ty, o Fadil! — tha.

Atë natë kemi biseduar gjer vonë.

— Kam menduar gjatë këto ditë — më tha. — Deri më sot s'kisha menduar për fejesë, ndonëse e kam kthyer kokën shpesh prapa për të parë më mirë gocat që kalonin rrugës. Mirëpo tani diçka ndjej. E pres me shqetësim ditën, kur do të ikim nga fshati. E kam fjalën për atë kooperativisten...

— E ç'ma zgjat hesapin atëhere?

Një ditë e pashe Lekën tek bisedonte me vajzën.

Fytyrat u qenë skuqur, po... nga turpi, a... nga të ftohtët? E pse ishte aq ftohtë, kur soba bubullonte? Po dyshemeja pse qenkësh e bardhë, mos e kishin mbuluar me pambuk?

— Do të më çosh mua shkesë, o Lekë? — e ngacmova njëherë.

Shejtani!

— Sot, — më tha — shoku Fadil, u ka kaluar koha atyre lojërave. E duhet ta dish se ajo akoma s'po e thotë fjalën e saj. Po mendohet gjatë e unë jam me zemër të ngrirë. Sa për shkuesit, u ka ikur koha atyre — tha përsëri dhe shkoi e u fut në valle.

Po në sallë përse paskan hedhur shirita të bardhë? Ja, edhe dyshemeja qenka me pambuk. Copa pambuku të bardhë fluturonin në ajër. Po... ç'të shihje, edhe rrobat e njerëzve po ktheheshin në të bardha! Ku e kishin gjetur atë mbrëmje gjithë atë pambuk? Mos ishte vallë nata e vitit të ri?...»

Traktoristi tundi kokën aq sa mundi. I ra xhamit, e, s'u kuptua në plasi e ju ça balli, apo u kthye cipa e akullit. Pas një sekonde, në ballin e dërmuar i rrodhi gjak. Dhembja në ballë dhe trupi i ngrirë i treguan se ndodhej në rrugën e akullit.

Ai tendosi në kulm nervat dhe shtrydhi të gjitha forcat.

XIX

Syri i përgjumur mezi i shquante «Skodat». Përreth një zjarri qenë ulur shoferët e tyre. Trak-

tori hidhej me zhurmë sa në një anë, në tjetrën. Ai rënkonte si i lodhur nga përlëshja me borën dhe vetëm buçimat e tij e mbanin zgjuar traktoristin. Luftë me vetëveten. Në arritjen e një qëllimi të madh bëhet një tendosje e të gjithë organizmit. Njeriu humb ndjenjat dhe fuqia, në këto raste, bie dy herë.

Ai po u afrohej përherë e më tepër njerëzve. Para sysh i vallëzojnë pa kuptim hijet e tyre. U shkon drejt. Ata ngrihen më këmbë dhe ikin të trembur. Fadili, me kokë të varur e i përkulur mbi timon, e rrotullon atë. Bën një kthesë të fortë. Heq dhe pjesën e fundit të borës, që gjendej te turiri i «Skodës» së parë dhe, me sytë të skuqur gjak e gjysmë të mbyllur, tërheq automatikisht marshet. Pa e shuar motorin, stop në vend!

Koka i ra si e këputur në gjoks dhe ngadalë si një trup i brumtë u shtri në kolltuk.

Shoferët, që e morën këtë turrje të traktorit drejt tyre si shaka, pritën ta shihnin traktoristin. Ata, me buzë në gaz, zgjatën kokën për ta parë. Pritën ta shihnin të zbriste duke shtyrë portëzën për t'i përshëndetur. Do t'i shihnin edhe sytë e buhavitur nga gjumi i tepërt që do të kishte bërë në dyshekun e ngrohtë në atë përcëllimë. Pritën ta shihnin të zbriste madhështor, se i çliroi nga vargojtë e dimrit, pritën t'i mallëkonte pa të keq, që e nxorën në atë të ftohtë... Pastaj, ata do t'i jepnin një cigare e çdo gjë do të rridhte si uji i qetë e i pastër. Pritën... por asgjë s'lëvizi!

Fadili po binte në gjumin e borës. Ky gjumë e nanuriste në krahët e tij të butë, të padukshëm e të shumëngjyrshëm, po e futte në botën e kujti-

meve, Fadilit i dukej sikur ishte ulur në majën e një mali të lartë e ndërsa agimi akoma s'kishte plasur, ai po këndonte dhe i binte mandolinës. Në atë melodi atij i dukej sikur ndjente zhaurimën e ujërave të ftohta e të kristalta të maleve, sikur shihte krojet e kulluara të fshatit që ndritnin nga rrezet e diellit pranveror, cicërimën e ëmbël të zogjve në një kopsht ku kanë çelur kajsitë, fishkëllimën e mprehtë të tufanit të egër. Atij ju duk sikur shihte Agimin e tij që vinte me vrap nga shkolla i gëzuar, ndërsa vetë nxitonte për tek e shoqja, Shkëndija, mbushur duart me mimoza për t'i uruar asaj festën. E nëpërmjet këtyre kujtimeve, duke humbur, atij ju bë sikur pa se mbi majat e maleve zvarriteshin fasha mjegulle të bardhë qumështore, të cilat, sa shkonte, herë shtoheshin e herë shkriheshin si një imazh i papërceptueshëm.

Fadili ndjeu diçka nëpër gjumë. Dëgjoi se dera u hap. Një zë i frikshëm thirri:

— Ej, shokë, shokë! Traktoristi është shtrirë!... Paska mbyllur sytë!

Njeriu hyri brenda. Nga ana tjetër nxituan e u futën edhe dy të tjerë. Ata e kapën, e luajtën, e prekën me dorë, ku mundën, dhe e kuptuan se ai po ngrinte.

— Ky ka udhëtuar shumë në të ftohtë, prandaj e ka zënë gjumi i borës. Duhet ta ngrohim, ta ndihmojmë, se do të na vdesë! Ka ngrirë përgjysmë! — foli e briti me një frymë njëri nga shoferët.

Traktoristi nuk dëgjonte asgjë. Ai kishte rënë në një gjumë të thellë.

— Po shkoj ta ndez maqinën time. Duhet çuar

në spital. Ju bëjini disa lëvizje të krahëve!

Dy të tjerët u përpoqën ta ndiznin maqinën. Ata u sollën rreth saj gjersa nga skapamentua nisi të dilte një tym i zi e me erë të rëndë.

— Dha ndonjë shenjë? — erdhi dhe pyeti shoferi i parë.

— Jo! — tha me dëshpërim tjetri.

— Kape ta futim në maqinën time!

Maqina u nis drejt minierës, duke i rënë pa pushim borisë. Jehona e stërzgjatur nëpër luginë i shpaloste gjiret e maleve shpatullgjera, ku dredhonte rruga e hapur. Sirena e saj i hiqte trishtimin natyrës dhe ngjante si një raketë e kuqe në një qiell blu të pastër, e cila lajmëron fitoren.

PARTIZANJA

*Dëshmoret dibrane, 16 vjeçares
Rukiye Roshi*

Ne festonim fitoren mbi armiqtë. Vendi ziente nga këngët, vallet dhe muzika. Qyteti ynë i vjetër i varur në kodrën e Kallavares i ngjante një zvarniku të madh, i cili, pasi kishte kaluar acarim e hidhur të dimrit, i mbledhur në vetëvete, ishte zgjuar dhe po çpinte në diell gjymtyrët e kruspu-llosura. Gjer para disa orësh këtu bëhej një luftë e ashpër. Njerëzit e kishin humbur toruan, s'guxonin të dilnin në prak të derës dhe askujt s'i vinte mendja të këndonte. Më pas qytetin e pushtoi thirrja jonë partizane... Partizanët ja nisën të parët edhe këngës. Me ne u bashkuan daullet dhe gërnetat. Kush i kishte ruajtur ato instrumenta në ato ditë të zeza terrori dhe luftimesh?

Kompania jonë po kërcente pranë furrës së djegur pranë pazarit. Deri dje furra ishte kthyer në një bunker misterioz. Gjermanët kishin vendosur një çerdhe mitralozi dhe kontrollonin nga lart njerëzit që vinin të piqnin bukë. Ata ruanin që të mos merrnim bukë ne, partizanët, dhe, sa herë që kolonat

tona vraponin në xhade, mitrolozat e tyre qëllonin. Njëherë menduam t'a asgjësonim me mortajë që nga Dobrova furrën, mirëpo rreth saj kishte shumë shtëpi dhe patëm frikë se mos gjyket tona binin gabimisht mbi ndonjërin nga çatitë. Në këtë furrë dukej sikur magjia kishte pleksur jetën dhe vdekjen, bukën dhe plumbin. Kështu furra u kthye në një përbindsh. Por, mbrëmë përbindshi u shkaktërrua, sikur të kishte qenë një lodër e keqe kalamajsh. Atë e dogji furrtari; ndonëse ai jetonte me të ardhurat e saj, ai i vuri flakën. Gjermanët e kuptuan vonë dhe, po të mos ishin hedhur nga çatia, do të ishin bërë shkrumb... Vallen e hiqte Rahimi, një lab i gjatë, i cili është arratisur nga burgu i Tiranës. Me ne kërcente edhe furrtari. Ai përplaste fort këmbën përtokë dhe rrihte shuplakat.

Edhe një batore pushkësh përshëndeti përtej fitoren. Pas saj u dëgjuan këngët partizane. Nga Begjunezi dha ballë një kolonë e gjatë. Përpara u printe një flamur i kuq. Ne nuk e dinim se të cilit batalion ishin ata, megjithatë vështronim se mos shihnim ndonjë të njohur. Takimet e papritura lufta i ka. Nga mesi i kolonës më tërhoqi vëmendjen një fytyrë partizani. Një tufë flokësh të prerë i dilte poshtë kapës e i hijeshonte ballin. Partizani ecte me kokën lart. E shikova me kujdes dhe ndjeva se po më rrihte zemra.

— Partizanja! — përshpërita i habitur dhe i thirra.

Ajo qëndroi në vend dhe më pa me vëmendje një çast, pastaj u sul te komandanti, diçka i tha me të shpejtë, duke lëvizur këmbë e duar dhe vra-
poi drejt meje duke thirrur e gëzuar. Ajo erdhi me

një buzëqeshje në buzë, ndërsa sytë e zinj si vishnje të pjekura i shkëlqenin më tepër se kurrë.

Takimi ynë qe i përmallshëm. Ajo më hidhej në qafë, më pyeste për gjithshka që i kujtohej dhe fjalët e saj s'kishin të mbaruar. Kur desha t'i tregoja për motrën, ajo heshti. Në sy i ndritën lot. Papritur heshtëm të dy dhe vështruam nga Dubleci, në drejtim të lagjes sonë. Sa e rëndë ishte kjo heshtje! U dëgjuan tingujt e borisë dhe «Partizanja» iku kokulur. Ishte dhënë urdhëri që të mblidheshin te kazermat në Pollozan.

Kujtimi i motrës ma ndrydhi gjoksin. Unë e mora vesh lajmin një javë pas vrasjes së saj. Ne duheshim shumë. Atëhere ishte vjeshtë dhe frynin erëra të marra. Erdhi komisari, më mori për krahu dhe, si u ulëm diku, më dha me zor të ndez një cigare. Ai e kishte shumë të vështirë, po unë e kuptova menjëherë. «Motra ime e vetme!» U ngrita dhe mora rrugën drejt pyllit. Lotët më rridhnin vetëvetiu faqeve dhe ecja si i humbur. Një trishtim i thellë më çante kraharorin. Unë qava me dënese për motrën. Ishte vjeshtë dhe pemët kishin lëshuar kudo gjethet e zverdhura. Sa e donte vjeshtën! «Në vjeshtë, thoshte, vajzat zbukurohen». Prandaj asaj i pëlqente zakoni i mirë i fshatarëve që i bënin dasmat në vjeshtë. Motra ime s'do t'i shihte më vjeshtat dhe kur të fitonim lirinë s'do ta kisha pranë.

Motra dhe «Partizanja» ishin natyra krejt të ndryshme. Motra ishte e hedhur, gjithmonë e qeshur. Ajo rendte në shtëpi si një flutur dhe të dukej sikur gëzimi s'do të ndahej kurrë prej saj. «Partizanja» ishte e qetë, fliste ngadalë e duke u men-

duar. «Partizanja» ishte jetime dhe kishte vetëm babain. Ata ishin shumë të varfër. I ati s'kishte ta ushqente dhe një mëngjez e solli nga fshati. Ai e pajtoi shërbëtore te një tregëtar që banonte në lagjen tonë. Nënës ju dhimbs, kur e njohu dhe e ftonte herë pas here në shtëpi, kurse motra u bë shpejt shoqe e ngushtë me të. Ajo ishte e hollë dhe e thatë si karthi, kishte flokë të verdhë, të drejtë, të cilat i thurte gërsheta. Gjithnjë vishte një fustan me arna. Çdo mëngjez në verë, sa plaste drita dhe në dimër mes borës e dëgjoja kur shkurtonte drutë në oborr. Të dyja merreshin me punëdore dhe se ç'fjaloseshin vesh më vesh. Një ditë «Partizanja» m'u afrua me të shpejtë si një zog i trembur dhe më tregoi një fustan basme, që e kishte bërë me të hollat që i kishin dhënë pas kaq kohësh. Vajza e kishte mbushur gjithë fundin rreth e qark fustanit me yllka të kuqe me pesë cepa.

— Ti qenke bërë partizane! — i thashë me shaka.

Ajo u skuq, ngriti kokën e më pa drejt në sy.

— Partizane... Po partizanet nuk kanë frikë, kurse unë, unë, kur vjen nata... Nuk më përcjell ti gjithmonë mua në shtëpi?

Qesha. Vërtet që, sa herë dëgjonim ta thërriste e shoqja e tregëtarit, e çoja gjer te porta. Flitej se muzgjeve në rrugë dilnin xhindë e lugetër, të cilët kobisnin vajzat e reja dhe gratë e bukura.

— Pse, a mund të quhem unë partizane? — pyeti ajo përsëri me një farë drojtje. — Partizanet janë trime e luftojnë për ne. — Toni i ngrohtë i zërit të saj përmbante edhe nuancat e habitës e të dëshirës dhe, nga shprehja e saj që ishte kthyer e tërë drejt meje, nga përpëlitja e dendur dhe e

pa zakontë e qepallave, kuptova shumë gjëra. Të dy vajzat ëndërronin për partizanët. Në shtëpi çdo darkë ne flisnim për ta. Nuk kaloi shumë dhe filluan të flisnin edhe në prani të «Partizanes». Se është vështirë që shpresën njeriu ta kyçë e ta mbajë për vete, kur ajo gëzon edhe të tjerët. Lufta që kishte nisur ishte shpresa dhe gëzimi ynë i përbashkët. Bisedat për luftën zëvendësonin tregimet për kuçedra e fantazma, përrallat e pafundme dhe kujtimet e zymta. Këto biseda mbushnin me dritë qytetin e, ndonëse gjurmoheshin, ishin të pakapshme si rrezet, se sikur vinin bashkë me diellin. Kur binte mjegulla, na dukej se spiunët i zgjatnin hapur duart e tyre të zeza dhe atëhere këto biseda mblidheshin nëpër familje, pëshpëriteshin nëpër kapexhikët e shtëpive dhe rriteshin pranë vatrave në dhomat e zjarrit, ku tregoheshin. Më kujtohet se si më shikonin dy vajzat kur u tregoja ato që kisha dëgjuar për luftën partizane, si shastiseshin e s'e hapnin gojën një copë herë. Në imagjinatën e tyre partizanët kishin hyrë si një botë e madhe, e ndjerë dhe e mbushur me ngjyra, e panjohur, por e dashur. Dhe jam i sigurt po të them se edhe dy vajzat, si të tjerët, i shikonin ata në ëndërr. Lufta ishte përzier me ëndrrat e tyre, ndërsa figura e partizanëve ishte ulur këmbëkryq në fantazinë e pastër. Partizanët, heroizmi dhe bëmat e tyre ishin bërë ideali i dy vajzave dhe njeriu është i lumtur me idealin e tij.

— Ti nuk ke dëshirë të luftosh? — e pata pyetur «Partizanen».

— Si s'kam. Por s'më lë zonja. — Ajo ra në mendime dhe s'foli më.

Që prej asaj dite unë e thërrisja fshehurazi

«Partizane». Ky emër i ri sikur i dha zemër. Një pasdite në kohën e një bombardimi të papritur të gjithë ne shkuam me vrap dhe u fshehëm në bodrumin e një fqiu. Atje erdhi dhe tregëtari me të shoqen dhe djemtë, kurse «Partizanja» jo. Ajo kishte qëndruar te praku i portës dhe kish ndjekur me sy avionët, që gumëzhinin si bumbullat dhe vërtiteshin si të hutuar. Kështu kalonin ditët. Ditët iknin të mbushura gjithnjë me një urrejtje të padukshme, por eksituese, si një ngarkesë eksplozioni.

Koha rrodhi dhe unë dola partizan. Më vonë dhe ato të dyja kishin ikur njëra pas tjetrës, lagjja ishte alarmuar për dy vajzat. Ky ishte alarmimi i botës së vogël e të ngopur që ka qejf të llap për gjërat e reja, të dëgjojë për to nga larg, por pa e prishur qetësinë e saj. Kurse ne të varfërit ishim ngritur me besim në fitoren e madhe...

Në mbrëmje «Partizanja», komandanti dhe një shok tjetër erdhën te ne në shtëpi. U mblodhëm në atë dhomë të ngushtë dhe biseduam gjatë. Nëna dhe «Partizanja» u pushtuan me mall. Unë prisja të shihja të përlotur sytë e rrudhur të nënës, por ajo i hodhi «Partizanes» një dorë në shpatulla dhe i lëmoi lehtë flokët. Kur ne u ulëm rreth vatrës, vajza shkoi të shihte shtëpinë. Mirëpo u vonua. Unë e gjeta të ulur në qoshen e dhomës, ku ajo rrinte me motrën dhe të dyja qëndisnin nën dritën e llambës.

— «Partizane! — i thashë unë. Zëri im tingëlloi i fortë e i ashpër. Ajo u ngrit, fshiu me kurrizin e dorës lotët dhe më zuri me besim për krahu.

Nëna kishte mbushur prehërin me ftonj dhe na i ndau me duart që i dridheshin. Sa shumë i dridheshin duart nënës dhe sa ishte plakur! Ajo kishte vënë në kokë një shami të zezë, të ulur gjer poshtë mbi vetulla.

Folëm për shokët e rënë. «Partizanja» nuk u prish asnjëherë në fytyrë, veçse sytë e zinj i shkëlqenin nga një dritë e brendshme. Nisi të kallzonte edhe ajo vetë për mitralierin që ishte vrarë pranë saj.

Në oborr një grup partizanësh kishin ndezur zjarr dhe piqnin misra. Ata këndonin dhe kënga e tyre vinte në dhomë si sfond i përflakur i një ngjarjeje jetike. Lodhur nga rruga, përqëndruar në botën e fuqishme të këngëve partizane, «Partizanen» e zuri gjumi me kokën të mbështetur te supi i nënës.

...Mesnata na gjeti në marshim në tragën e një pylli të dendur. Komandanti na tregoi se do të sulmonim kullën e bajraktarit. Pararoja jonë kishte kapur një lajmëtar që ai kishte nisur për te gjermanët për t'i ardhur në ndihmë, ndërsa vetë ishte ngjuar në kullë me disa katila. Pararoja kishte diktuar edhe mercenarët e tij që po mblidhnin njerëz në fshatrat përreth, si përforcime.

Vetulla e hënës së re përziente hijet e pemëve me konturet e maleve dhe ne shpejtonim nëpër mugëtirën e toneve të zeza të errësirës së natës. Përpara nxitonte «Partizania». Gërsheti i trashë i flokëve të verdhë luhatej para meje si një lavjerës. Duke shkuar të luftonim me bajraktarin, ne sikur shkonim të mposhtnim sfinksin e llahtarshëm të tmerreve të krahinës sonë, se gjithshka e keqe lidhej me ligësitë e tij. Njerëzit thoshin se vetë

bajraktarin s'e kap plumbi. Flitej se trupi i tij përmbante diçka të veçantë që i largon plumbat, prandaj, edhe kur kishte rënë në kurthe, s'ishte plagosur ndonjëherë.

Kulla na doli përpara si një piramidë vdekjeje. Frengjitë e ngushta ngjanin si sytë e mbyllur të një qiklopi që flet, të cilin mjafton ta ngacmohet pak që të zgjohet e të të godasë edhe me shigjetat e zjarra të syve të ndezur. Si e rrethuan kullën, kur komandanti briti që katilat të dorëzoheshin, kulla u zgjua përnjëherësh dhe ne na qëllonin nga të gjitha frengjitë. Zjarrit të tyre ju përgjegjën të gjitha bateritë tona.

Unë e «Partizanja» qëllonim rrallë. Ne kishim zënë vend në shpinë të kullës, atje ku muret ishin futur në pyll. Gojë më gojë erdhi edhe te ne urdhëri: «Të ngushtohet rrethimi dhe të merret kulla para se të agojë. Të mos u lihet kohë mercenarëve që të vijnë me forca». Shtimë me breshëri dhe shkuam disa metra përpara. Zëmë pozicione pas drurëve, pak më thellë së lirishtja e ngushtë e pyllit.

Befas në krahun tonë të djathtë gjëmoi një shpërthim. Pas shpërthimit ra një heshtje aq e thellë, sa që ne kujtuam mos u shurdhuam. Nuk kaloj shumë dhe ne pamë komisarin. Komisari mbante një partizan.

— Kush u plagos? — pyeti «Partizanja» dhe i doli përpara.

Komisari s'foli. Ai e uli me kujdes përtokë trupin e partizanit.

— Na e vranë Rahimin — tha.

Ne u tronditëm dhe shtrënguam armët me gishtërinjtë që na dridheshin.

Partizani lab Rahimi ishte zvarrisur gjer të muri i kullës, kishte vënë një pako dinamit, por, kur kish ndezur fitilin dhe kish vrapuar të largohej, e kishin parë dhe e kishin qëlluar. Pastaj komisar i kishte shkuar fshehurazi dhe e kishte tërequr trupin e tij.

Dinamiti kishte hapur një goll të madh dhe që andej disa partizanë qenë futur brenda. Tani lufta kishte arritur kulmin. Por a do ta vrisnin dot bajraktarin, po sikur ta kapnin të gjallë?

«Partizanja» kërceu e u shtri pranë meje.

— Shiko, — më tha — një hije po largohet tutje.

— Do të jetë ndonjëri nga shokët tanë.

— Jo — tha ajo. — Mua m'u duk se ai u hodh nga një dritare.

— Po kush do të jetë, — pyeta unë — se kjo natë t'i verbon sytë?

Në vend të përgjegjes «Partizanja» kishte marrë nishan dhe qëllloi. Hija, si të ishte ndonjë fantazmë, u zhduk.

— Ç'është? — tha komisar i, që u gjend përsëri aty.

— Diktova një hije dhe e qëllova — tregoi «Partizanja».

— Ejani — tha ai.

Të kërrusur shkuan pas komisarit.

Pranë një dëllinje të egër pamë një njeri të shtrirë. Pozicioni si kishte rënë ai na bëri të qëndronin një copë herë në këmb, para se ta shihnim se kush ishte. Dukej se në fillim kishte rënë në gjunjë, pastaj ishte shtrirë në një krah. Duke rënë, kishte këputur një degë të tërë dëllinje, të cilën e kish shtrënguar në dorë, ndërsa kokën e kish

ngjeshur përtokë, sikur kërkonte të hante dhë. «Partizanja» qëndroi dy hapa larg dhe ja kish ngulur sytë atij trupi. Nga shprehja e fytyrës kuptohej se ajo mendonte e drithëruar mos që ndonjëri nga shokët tanë. Ky njeri rrinte para nesh si një lëmsh i madh e i ngatërruar.

Komisari e ktheu me fytyrë nga ne. Në errësirën e thellë s'e dallova dot se kush ishte.

— Kush është vrarë? — pyeti nga pas «Partizanja».

Mohova me kokë, por nuk e di nëse më pa.

Komisari u ngrit dhe më vështroi pa folur. S'e kishte njohur. Kur unë u përkula, ai nxori elektrikun e dorës dhe lëshoi dritën mbi fytyrë. Edhe sikur të kisha rënë mbi gjemba, s'do të isha ngri-tur aq shpejt.

— Bajraktari — thashë.

Komisari e shoi elektrikun sikur drita e zbetë e tij të përlyhej në atë fytyrë të urryer. «Partizanja» rendi, u përkul mbi të, u kthye e më pushtoi mua dhe vrapoi të lajmëronte komandantin. Unë bëra disa hapa drejt kullës dhe i çmendur nga gëzimi thirra dy herë fort.

— E — hej, u vra bajraktari!

Thirrjen time e përtëriu dikush edhe nga balli i kullës.

Në kullë pushuan të shtënat dhe ra qetësia.

Agimi e leu natyrën me argjend. Mbi majat e pishave bariste ylli i karvanit.

TAKIMI I PARË

Çdo mëngjez, duke nxituar për në spital, vendosja që të nesërmen të ngrihesha më shpejt e të mos nisesha si i marrë. Mirëpo në mbrëmje bija prapë vonë. Për këtë më kishte ndihmuar edhe sportelisti i hotelit, i cili vetëm kur s'kishte ç'të bënte, më dërgonte njeri në dhomë. Po të shumtën e netëve isha fillikat. Atëhere mendoja gjatë për të sëmuret. Shfletoja libra e dispenca e kështu, duke u rrekur pas tyre, rrija deri vonë. Bile kjo m'u bë e zakonshme. M'u bë e nevojshme edhe se në spital pacientët dhe infermierët nuk më thërrisnin me emër, por thoshin: «doktori i ri». E jo vetëm për moshën.

Sidoqoftë përsëri duhet të shpejtoja, se isha vonë. Zbrita me vrap shkallët. Nga korridori i ngushtë vinin përzier disa zëra. Në të afruar dëgjova një zë femre që thoshte:

— Ejani pasdite, se përgjegjësi atëhere vjen. Po mos u vononi se, më duket, s'ka vende.

Dy burrat, prej të cilëve njëri ishte me një çantë zyrtari në dorë, se ç'thanë midis tyre.

Ajo që foli ishte një grua e re, me trup me-

satar e me flokë të prerë shkurt. Këtë grua s'e kisha parë ndonjëherë e nuk e dija se ç'bënte.

— Besoj se mua s'do të më lini pa vend — i thashë unë.

Ajo u kthye e tëra drejt meje. Drita që hynte në korridor nga dera e ngushtë u pre nga trupi i saj. Gruaja qeshi pa zë duke shtrënguar buzët e vogla lyer me të kuq.

— Ju jeni doktori? — më tha.

— Nga më njihni?

— Të njoh se... ku di unë... nga syzet e zeza — tha ajo, u afrua e më zgjati dorën.

— Do t'i them vetë përgjegjësit që t'jua ruajë vendin e të mos ju sjellë njeri as kësaj jave.

— Kush jua tha këtë? — e pyeta me kureshtje, sepse dinte rreth meje disa hollësira.

— I lexova te libri i regjistrimit.

Desha të largohesha se qeshë vonuar, po gruaja vazhdonte të mbante akoma dorën time në dorën e saj.

— Tani do të iki — i thashë asaj sikur t'i kërkoja të falur për një muhabet të prerë përgjysmë.

— Ti, doktor Arbeni, përherë nxiton.

Rrudha vetullat me habi.

— Të kam parë dy ditë rresht. Ti shkoje në spital, kurse unë vija në hotel.

— Ashtu?

— Po. Unë kam tri ditë që shërbej këtu.

— Nga qyteti jeni?

— Jo — tha ajo. — Jam nga bregu i detit, nga Sh. Vij çdo ditë me urban. S'është as njëzet minuta larg.

— Mirë u pafshim! — i thashë unë dhe u largova.

Duke shpejtuar në rrugën e rrethuar me mimoza, përshëndetja të njohurit e parë dhe mbushja mushkëritë me ajrin e pastër të mëngjezit, se kështu e ndjeja që çlirohesh nga ajri i rëndë i natës i dhomës ku flija. Qyteti që ishte zgjuar me kohë ishte mbushur me zhurmat e ditës. Nxënësit veshur me pallto vraponin pranë pellgjeve me ujë, ndërsa shkollarët e shkollave të mesme me shallët e leshta lidhur në gushë, më ngjante se më vështronin me bisht të syrit. Nuk e di pse më është bërë zakon që, sa herë shkoj apo kthehem nga puna, të shoh me kureshtje hotelin e ri që po ndërtohet përbri rrugës. Kjo ndoshta vjen se një kolegu im, ditët e para, kur më prezantoi me qytetin dhe më foli për të ardhmen e tij (ai do të bëhet një qendër e madhe turistike), më tregoi të parin hotelin. Hoteli i ri që do të ishte pesëkatësh e me ashensor e që banorët thoshin se ishte i tepërt për këtë qytet të vogël, do të vinte koha që të mos i përballonte kërkesat e shumta. Këtë mendim kisha edhe unë.

Në lindje ngriheshin avuj të imtë e të butë dhe dukej se toka ishte ngrohur. Juga që vërshoi nga deti bëri të shpërthenin mimosat. Po kjo s'mbajti shumë dhe nisi të ftohtët. Tani ngricat mëngjezore qenë zbutur dhe natyra po merrte ngjyrat e saj të freskëta. Por toni i bardhë i borës zotëronte akoma.

Në spital s'e kuptoja si më kalonte koha. Pas mbledhjes së mëngjezit unë qëndroja gjatë te koka e të sëmurëve dhe, kur kisha ndonjë rast të vështirë, konsultohesha me shokët, me librat dhe mbaja edhe shënime në ditarin tim mjekësor. Ndoshta vitet dhe zhvillimi i mjekësisë moderne do t'i bënin të panevojshme këto shënime pune, megjithatë bloku im mbushej me emrat e antibiotikëve më të efektshëm.

Unë kërkoja të përparoja shpejt në zanatin tim, jo se i urreja eksperimentet e gjata, por kisha lexuar diku se në mjekësi, po u vërtite me vite të tëra pa një mendim të prerë, mbetesh gjithnjë amator. Por nuk kisha gjithmonë sukses, ndaj nganjëherë më mbulonin mendimet e trishtuara. Në këto raste shkoja në dhomën time në hotel dhe bija të flija. Gjumi ma largonte zyrtësinë dhe unë filloja punën më i qetë...

U ktheva në hotel më herët. Në korridorin e ngushtë s'kishte asnjëri. Duke ngjitur shkallët, dëgjova se në katin e dytë binte një muzikë. Muzika sikur vinte nga dhoma ime. Mua më kujtohej se transistorin në mëngjez s'e kisha prekur fare, ndërsa në të vërtetë e paskështa lënë hapur. Kaq shumë i shqetësuar paskam qenë sot?! Ky mendim më tronditi dhe unë hapa me vrull derën. Mbi shtratin tim ishte ulur gruaja e hotelit. Me kokën e mbledhur midis dy pëllëmbëve ajo dëgjonte me vëmendje transistorin që ishte mbi komodinë. Dera që u hap me forcë e trembi dhe ajo u ngrit në këmbë duke u përpëlitur e frikësuar. Si përherë në të tilla raste, kur s'dija ç'të thosha, vura buzën në gaz.

— Më falni, — pëshpëriti ajo me buzët që i dridheshin — unë...

— Ju lutem, qëndroni, uluni — i thashë për ta qetësuar.

Gruaja u ul menjëherë ku ishte. Nga transistori vinte një muzikë ritmike, e cila të grishte për të vallëzuar.

— Faleminderit, doktor! — dëgjova gruan të më thoshte. — Unë mendova se ju do të më bërtisnit, do të më shanit që e nxora transistorin nga komodia dhe e hapa pa lejen tuaj.

— S'prish punë, — i thashë — vetëm se ka ardhur koha për t'i ndërruar bateritë.

— Ju jeni me të vërtetë njeri i mirë, ju jeni shumë i sjellshëm dhe i urtë. Unë e dija këtë. Para ca ditësh më foli një shoqja ime nga Sh., të cilën e kishit vizituar me kujdes dhe për një kohë të gjatë — më tregoi ajo.

Fjalët e saj më bënë të skuqesha në fytyrë dhe, për të këmbyer bisedën, e pyeta:

— Sa vjeç jeni?

— Njëzet e tre. Kam dhe një fëmijë.

E vështrova me habi. Ajo ishte shumë simpatike ose më sakt e bukur. Kishte sy të mëdhenj me bisht e me qerpikë të gjatë, vetulla të holla dhe një hundë kryeneçe, të rregullt e me majë të kthyer pak përpjetë.

— Ju dukem më e madhe? Ej, doktor, të vraka jeta!

Këto fjalë më habitën më tepër. Por, ngaqë s'desha të hyja në hollësira, i thashë:

— Ju pëlqen shumë muzika? Besoj se shkoni shpesh në mbrëmje?

— Mbrëmjet?! Kam filluar t'i harroj. Kam shumë dëshirë që herë pas here të vallëzoj, të shkoj në kinema. Ju nuk e dini që, para se të martohesha, këndoja në grupin artistik.

— Po tani ju pengon fëmija?

— Jo — tha prerë — më. . . — dhe heshti.

Nuk e pyeta më gjatë. Ajo diçka deshi të thoshte, se dukej që kishte një brengë të madhe.

Ja ndërrova stacionin transistorit dhe nxora zha-
ketën. Gruaja u ngrit, dhe, si tha: «Faleminderit!», u largua ngadalë.

Pas kësaj ngjarje kaluan dy ditë. Gjatë këtyre ditëve mua më dukej se shihesha më shpesh me këtë grua. Tani përveç orëve të para të mëngjezit, atë e gjeja aty edhe pasdite. E pyeta pse qëndonte kaq gjatë. Ajo më tha se autobus urban kishte gjer natën vonë.

Pranvera as nuk u vonua e as nuk shpejtoi, ajo erdhi tamam në kohë. Unë e vura re atë papritur. Kur po kthehesha nga spitali, pashë se mbi pullazet e shtëpive një diell i ngrohtë, e kishte shkrirë vende-vende borën. Pranverën sikur e sollën atëherë kur duhej, «Skodat» e «Shytat» e ngarkuara që kalonin në këtë qytet të vogël që ndodhej në udhëkryqet e qyteteve të mëdha. Maqinat, duke ardhur e duke shkuar midis pranverave të hershme e të vonuara të qyteteve të ndryshme, të dukej sikur e mblidhnin pak nga pak dhe në një ditë të zakonshme e sillnin mbi ngarkesat e pambuluara me mushama.

Ndërrimi i stinës dhe përgjithësisht ardhja e pranverës ndikon mjaft në organizmin e njeriut. Bora që shkiste tatëpjetë përrenjëve, ujërat e kristalta që rridhnin, zogjtë e pranverës që harliseshin degë më degë, dielli që gëzonte zemrat, të gjitha këto kishin hyrë në qenjen time dhe unë isha bërë akoma më i butë, se sikur ndjeja të më frynte gjithandej ëmblë një fllad lumturie. Zemra ime sikur ishte rritur, sikur ishte holluar dhe i ngjante një enë prej qelqi, e cila, sa herë që ta prekësh, tingëllon lehtë. Ajo mund të mbante të shtrenguar shumë dashuri, por mund të shpërndante për të tjerët qindra herë më tepër dashuri.

Ndërsa jetoja me këto hove, një mëngjez, pa u mbushur java, ajo m'u lut ta vizitoja. Nuk ishte

mirë me shëndet. Desha t'i thosha të vinte, kur kisha radhën në ambulancë, por pas kësaj njohjeje më erdhi zor ta bëja këtë gjë. I premtova se do ta vizitoja po atë ditë. Pasdite kisha dezurn, ndaj, pasi u lashë disa porosi infermiereve të pavionit, u largova sipas rregullit, dy orë para orarit.

Gruaja e hotelit ishte atje. I thashë të vinte në dhomën time dhe ajo pas pak erdhi. Në çastin kur hyri ajo, m'u duk sikur po bëja një faj. Ndosh-ta ardhja e saj ishte për mua një hap i gabuar. Po e mblodha veten.

— Si jeni, përse ankoheni? — i thashë.

— Nuk jam mirë, doktor. Para së gjithash jam shumë e shqetësuar. Ndodh që s'rri dot në një vend, kurse nganjëherë ulem diku dhe rri si e shastisur.

— Keni dhembje koke?

— Po. Zë e mendoj dhe atëhere sikur trullosem se fillon të më buçasë koka.

— Kur shkoni në shtëpi, qetësoheni?

— Përkundrazi. Kur më vjen koha të largohem prej këtej, atëhere ndjehem e këputur dhe më priten fuqitë. Vetëm më nxit foshnja që kam.

— Po burri?

Gruaja heshti. Që në bisedën e parë, kur ra fjala për të shoqin, unë diçka kuptova. Heshta se s'dija ç'ti thosha.

I mora dorën dhe i mata pulsën në heshtje. Mendova se mos vuante nga tensioni.

— Ah, doktor, më duket se as ju s'mund të ndihmoni. As ju që jeni kaq i mirë. As ju që jeni kaq i urtë — tha ajo ngadalë e mbyturazi sikur t'i drejtohej dikujt tjetër.

— Sa vjeç e ke fëmijën?

— Tre vjeç.

— Qenkeni martuar e re — i thashë, por e preva fjalën, se m'u kujtua që e kisha pyetur njëherë sa vjeç ishte.

— Kur u martova, isha nëntëmbëdhjetë vjeç. Po kanë kaluar katër vjet qysh atëhere. Ka kaluar gati një shekull.

— Pse flisni kështu? — i thashë.

— S'kam si të flas ndryshe, doktor. Se gjithshka që thuhet, është gënjeshtë, se muajt kur njeriu është i lumtur janë si një ëndërr.

Duke dëgjuar gruan që fliste, mendoja se është më lehtë të shërosh një sëmundje, se sa të zbulosh shpirtin e tjetrit.

— Mua më duket se ju, doktor, s'më kuptoni. Dhe keni të drejtë. Bile këto fjalë ju duken të çuditshme, se ju s'e njihni jetën time. Ndoshta jeta ime s'ju intereson fare. Më falni, por unë si të thuash, ndjej nevojën të flas me dikë.

Gruaja përsëri e preu fjalën. Uli kokën dhe shtrëngoi gishtërinjtë. Nisi të fërkonte unazën. Duke u bërë gati ta dëgjoja me vëmendje, e kuptova se ajo po më tregonte e shtyrë edhe nga ndjenja e thellë e besimit që kanë njerëzit rreth profesionit të mjekut. Njerëzit, duke ndjerë në jetën e përditshme ndihmën tonë në shërimin e dobësive fizike, besojnë se ne mjekët mund t'i shërojmë ata edhe në lëkundjet tronditëse shpirtërore. Në kokë më vetëtiu mendimi sa shumë duhet të përpiqemi që të jemi specialistë të zanatit dhe njerëz të vërtetë.

— Ne dashuroheshim aq shumë, saqë na dukej e bëhej gameti po të mos shiheshim dy herë në ditë. Ai

ishte i ri, ishte i mirë ja kështu si ju dhe ishte peshkatar. Kur vonohej, e prisja në breg të detit. Ai hidhej menjëherë nga varka dhe më takonte me mall. Netve uleshim karshi detit. Ai më fliste për dashurinë. Në fjalët e tij unë shikoja detin dhe hënën. Deti shtrihej i bindur në këmbët e mia, ndërsa hënën sikur e zbriste ngadalë dhe ajo më qëndronte pezull e varur mbi supe. Vetëm ato ditë kam qenë e lumtur në jetën time. Kjo vazhdoi edhe një muaj pas martesës, pastaj... e kuptova se kisha ëndërruar me sy hapur. Ai u bë një xheloz i prapë. Më ndaloi të këndoja në grupin artistik dhe bëri çmos të më largonte nga banaku i klubit të peshkatarëve ku shërbeja. Më shkëputi nga njerëzit dhe më futi në këtë hotel për të mos u takuar me shumë njerëz. Në klub unë takohesha me shokët e tij. Kur ata pinin apo s'pinin birrë, kur bënin muhabet me qejf ose e shtynin, e kuptoja se si i kishin punët, si u kishte vajtur gjuetia. Atëhere përpiqesha t'ja largoja atij mërzitjen. Po ai bëhej nevrrik dhe shpesh sillej si i egër... Kështu që s'guxoj t'i them një fjalë për të tjerët. Kaluan dy vjet që s'po dëgjoj një fjalë të mirë. Fillova t'i urreja tërë burrat...

Gruaja fliste dhe s'm'i ndante sytë. Kur heshti, sytë e bukur i ndrisnin, se në cipat e tyre kishin buitur dy pika lot. Qante.

U ngrita dhe dola jashtë.

Në prak të pranverës bëhem si i dehur, se gjithshka më duket fluide, harmonike dhe e lëvizshme, ndaj dhe jam gati të shkrihem për t'u dhënë

edhe të tjerëve pak lumturi. Gjaku më zien, çilem, ndërsa zemrën sikur s'ma nxe kraharori. Mirëpo e ndjeja se kjo pranverë po niste ndryshe. Po ç'të bëja? Me këto mendime u drejtova nga shtëpia e kolegut tim vendas. Të shkonim në Sh. dhe për të qenë të natyrshëm të merrnim me vete grepat dhe kallamat për të gjuajtur peshk. Për të qenë të natyrshëm? Vura buzën në gaz me ironi dhe tunda kokën. Përse të isha «i natyrshëm», kur vendosa të nisesha qëllimisht për të biseduar me peshkatarin?

Ktheva rrugën. Gjoksi m'u mbush me erën e këndshme të mimozave. Zgjata krahun për të këputur lehtë një degë, por s'arrita. Atëhere u hodha me forcë dhe e këputa degën me rrëmbim.

VULLNETARËT

— Maçina duhet hequr — tha edhe Aleksis: Ai pa nga dritarja agimin që po skuqej dhe dëgjoi këngën e vullnetarëve që vazhdonin të mbartnin në krahë listela e tulla.

— Po, po, maçina na duhet. Ja, tani, po ta kishim, do ta nisnim me gëlqere për në Lladome-ricë — tha shoku i shtabit me sy të skuqur nga pagjumësia. — Si dreqin i ndodhi këto ditë?!

— Ashtu është. Veç kësaj, s'duhen penguar njerëzit — tha edhe taktoristi. — Unë po nisem që tashti, si thoni ju?

Shoku i shtabit me sy të skuqur, me recepto- rin në vesh, pohoi me kokë.

— Për disa minuta më ke edhe mua pas — tundi kokën Aleksis.

Në shtab hynin e dilnin; njëri jepte urdhëra, dikush shkruante me nxitim në një copë pusullë dy fjalë, një zile telefoni ndihej.

«Stalineci» që ndodhej jashtë, shkuli pllakat e zinxhirëve nga bora e ngrirë dhe, si u rrotullua në vend, mori kthesën e u nis.

— Të marr ca dërrasa, — tha Aleksis — do të na duhen për atje.

— Përse?

— Po ja, t'i vendosim gur mbi gur e i afrohe-
mi maqinës.

Shoku i shtabit me sy të skuqur i shtrëngoi
dorën dhe i uroi:

— Punë të mbarë!

Maqinat e ngarkuara me materiale shpejtonin.
Asnjë nuk ndodhej bosh. Të gjitha lëviznin e diku
shkonin. Ai s'mund të priste më. Pastaj a mund të
pengoheshin maqinat në këtë kohë?

Dhe s'e vrau gjatë mendjen. Pellgu i Gradecit
ndodhej gjysmë ore larg. Aleks i shkoi te stiva dhe
zgjodhi tri dërrasa të gjata. U përkul, i vuri mbi
kurriz, po pesha e tyre e kërrusi. Pastaj u çapit
mes për mes borës.

Puna me turne e vullnetarëve e kishte zgjuar
që me natë. Re të vogla silleshin andej-këtej pa di-
tur se ku ta zbraznin borën.

«Ndoshta që i vetmi shofer që s'i njihte këto
gryka prandaj i ndodhi ajo që...» mendoi Aleks
dhe ju kujtua ngjarja.

Të ftohtët, që dita-ditës na vinte po shtohet, i
veshi malet me borë. Bora solli me vete prej
bjeshtëve një erë të ftohtë dhjetori që të mpinte.
Megjithatë nëpër kthesat zikzake dukej sikur ma-
qinat mbinin. Autokolonat me materiale për zhduk-
jen e rrëtimeve të tërmetit, lëviznin nëpër Dibër.
Nga qielli flokët e butë e të bardhë, herë si miza
e herë si flutura, derdheshin gjithnjë dendur e den-
dur. Maqinat me zinxhirë e pa zinxhirë e shtru-
an borën, e shtypën dhe e ngjeshën mirë. U for-
mua një akull i lëmuar si xhami që natën prozhek-
torët e maqinave e bënë të ndriste.

Në mbrëmje, në një kthesë të fortë, një maqinë pa zinxhir, rrëshqiti, gomat s'ju bindën frenave dhe ajo filloi të binte teposhtë. Shoferi arriti të dilte, ndërsa maqina ra në Drin, në pellgun e Gradecit. Kjo ndodhi në rrugën midis Shupenzës e Maqellarës, atje ku, nga një anë lartohen shkëmbinjtë e në krahun tjetër gumëzhin rrëmbyeshëm Drini.

Shoferi, që shpëtoi e që ishte futur në ujë gjer mbi gjunjë për të dalluar maqinën, arriti në mesnatë i tkurur. Me buzët e mavijosura, ai pëshpëriti disa fjalë dhe ata të shtabit e kuptuan ngjarjen. Mjeku urdhëroi që të shtrohej urgjent në spital, se mund të qe ftohur. Shoferi, që s'dinte ç'të bënte, ju bind.

Vullnetari, nën peshën e dërrasave, me bisht të syrit vështronte anash natyrën që i shpalosej.

Kaloi pranë stallave të kooperativës dhe vërejti dy kazanët e mëdhenj me ujë, që po i ngrohnin për të përgatitur llaçin.

— Hej, shoku vullnetar! — dikush i thirri Aleksit dhe ai ndjeu afër një frymëmarrje të rëndë. Pranë i erdhi një njeri. Ai mbante në duar dërrasa. E shikoi nën vetulla dhe... njohu shoferin.

— Po ti, more? — e pyeti me zë qërtues.

— Po vij për te maqina.

— Të lejoi doktori të dalësh?

— Ohu, doktori të mban për një kollë tri javë.

Sa ju pashë, më vajti mendja se po shkoni atje. I thashë infermieres, por s'qe e mundur. Ashtu. I mora një shoku pallton dhe dola nga dritarja.

— Unë të them të shkosh menjëherë.

— Jo, jo, në asnjë mënyrë.

— Atëhere, ose kthehu ti, ose po kthehem unë!

— e ngriti zërin Aleks i dhe ndaloi në vend. Shoferi u fut përmes borës dhe i doli përpara. Vijoi rrugën duke i thënë:

— Po ti mos u nxeh, mor shok. Ja, sa ta nxjerrim maqinën, të bëj nja dy rrugë dhe do të shkoj vetë të shtrohem.

S'kishte ç'ti bënte. Shoferi tha:

— Po ajo vullnetarja që iku, nga spitali pa mbaruar kurat?

Vijuan rrugën. Ndezën nga një cigare. Njëri mbajti me një dorë shkrepse, tjetri fijen. Aleks i nga pas i pa duart. Gjetei atë karakteristikën e për-bashkët për të gjithë shoferët. Duart i kishte të mufatura e të skuqura. Gishtërinjtë e enjtur i qenë nxirë.

Të dy janë vullnetarë. Gjer mbrëmë s'njihe-shin, por ja që tani u duket sikur janë njohur prej kohësh në kantieret e ndërtimit.

«Shoferi ndoshta s'i njihte këto gryka», mendoi Aleks i.

Bashkë me erën që nisi të frynte përsëri, Aleks i dëgjoi zërin e shoferit.

— Që ditën e parë erdhët në Dibër?

— Erdha ditën e tretë. Sapo pata filluar lejen e zakonshme dhe vajta në fshat. Lexova gazetën dhe u nisa.

— Çfarë profesioni keni?

— Jam elektrikist.

— Eh, ç'fat që paske.

— Si the?

— Paske fat, thashë. E di, apo jo, do të bësh elektrifikimin. Nga duart e tua do të shkëlqejnë kushedi se sa shtëpi. — Shoferi fliste me ndjenja.

— Edhe unë jam vërtet i kënaqur.

Asnjëri s'foli më.

«Duart i ka të enjtura e të çara dhe s'do t'ja dijë», mendoi Aleks i për shoferin.

Ata arritën gati me traktorin.

— Pse s'më thatë edhe mua të merrja ca dërrasa.

— E ku do t'i vije?

— Lija portat të hapura dhe i mbaja mbi gjunjë.

— Na mjaftojnë edhe këto.

Lëshuan dërrasat dhe kontrolluan vendin. Maqina ndodhej gati në mes të ujit.

— Po hedhim disa gurë në Drin, — tha traktoristi — pastaj po e zbres traktorin tek ajo ranishtëja, aty në breg.

Me dorë gurët nuk shkuleshin. Atëhere «Stalineci» ju turr bloqeve të gurëve aty pranë dhe i vërviti në lumë. Gurët u rrokullisën teposhtë, por... humbnin në ujët që i mbulonte.

— S'bëhet punë me dërrasat? — e hapi gojën për herë të parë shoferi, pasi arritën këtu.

— Zbresim poshtë!

«Stalineci» pastroi borën dhe hapi njëfarë rruge. Nga malet që zbardhnin nga bora nisi një erë me fishkëllima. Ajri u ftoh më tepër. Stalakitet e gjata të akullit vareshin nga anët e urës. Mbi ujët e turbullt notonin peta akulli.

Ç'të bënin? Maqina nevojitej shumë ato ditë. Pastaj, po ta lije tërë dimrin, do t'i shkatërrohej edhe motori.

— Na nxirr kavon!

Dy të tjerët u menduan një çast.

— Jo, jo, unë s'hynet në ujë. S'është futur gjer

më sot njeri në dimër në Drin! — tha traktoristi. Ai ishte dibran dhe kurrë s'kishte dëgjuar për një gjë të tillë.

— Të ngrin trupi e vdes në ujë! — foli shoferi.

— Kavon! — përsëriti prerë Aleks. — Duhet të futem pa tjetër në ujë.

Traktoristi shkoi të sillte kavon. Shoferi zbërtheu pallton.

— Jo ti — tha Aleks dhe nisi të zhvishej vetë.

— Atë maqinë ma ka dhënë mua populli! Do të hyj unë — nguli këmbë shoferi, duke hequr pallton.

— Për maqinën e popullit përgjegjemi të gjithë. Ti je ftohur. Këtu urdhëroj unë! — tha prerazi Aleks. Dhe u zhvesh vetë, duke mbajtur vetëm kanatierën e të mbathurat.

Ai mori kokën e lidhur të kavos që i dha traktoristi dhe u nis. Ujët e ftohtë të lumit e preu si brisk sapo futi këmbën. Një e rrëqethur e mprehtë i shkoi në trup. Pastaj e shpejtoi hapin, por duke e zgjedhur me kujdes vendin për të mos hyrë në ndonjë gropë. U fut gjer mbi gjunjë. Mornicat i mbuluan lëkurën e trupit. Thellësia sa vinte po shtohet. E, kur ujët i arriti gjer në mes, ju duk sikur një tel me gjemba po i shtrëngonte belin.

— Kujdes! — një britmë çau ajrin.

Aleks ktheu kokën anej nga tregonte shoferi me gisht dhe u tërhoq menjëherë mënjanë. Drejt tij aty pranë po vinte një copë akulli rreth një metër. Nisi të dridhej. Atëhere lëvizi me fuqi

disa herë krahët për t'u nxehur. Gjymtyrët ju mpinë dhe për një çast ju duk vetja si në ëndërr. Tani kavon, që ishte nderë mbi ujë, e merrte rryma me vete. U bë e pamundur të tërhiqej. U lodh shumë. Traktoristi e kuptoi këtë gjë. U zhvesh edhe ai nga mesi e poshtë. U fut në ujë gjer afër mesit. E mori kavon në duar dhe e mbështeti mbi gjoks, ndërsa shoferi atje në tokë e mbante mbi kokë. Kështu i dhanë mjaft ndihmë shokut.

Lartësia e ujit i vinte Aleksit gjer mbi gjoks. S'hidhej më hapi. U hodh me not. Notoi nëpër ujin e turbullt përmes riskave të akullit. Vetëm koka i dukej sipër. Edhe kavoja që zgjatej pas si gjarpër. Ja, arriti edhe te maqina. U kap pas saj dhe u ngrit përgjysmë. Futi kavon në ganxhat e përparme. E lidhi.

E ndjeu veten të pafuqishëm. U mat të fliste, por s'mundi. «Si m'u mor kaq shpejt zëri», u habit me veten. Kur u lëshua në ujë, bëri shenjë me dorë ta tërhiqnin. Shokët e kuptuan përsëri shenjën. Traktoristi u fut më thellë në ujë dhe së bashku me shoferin nisën ta tërhiqnin kavon me të shpejtë.

Aleksi doli gati i ngrirë. I merreshin këmbët.

Traktoristi dhe shoferi u sulën ta fshinin dhe ta vishnin. Ky fërkim dhe rrobat bënë që ai ta merrte disi veten. Traktoristi hoqi peliçen dhe kokoren e tij dhe ja dha.

Traktoristi e siguroi Aleksin në një vend që nuk e merrte era dhe shkoi te traktori. «Stalineci» nisi ta tërhiqte maqinën duke u ngjitur sipër. Kavoja u tendos dhe maqina nisi të notonte mbi ujë. Me

kujdes, për të mos u rrëzuar brinjazi, ai e ngriti në xhade.

Të ftohtët qe shtuar.

Shoferi, që s'e mbante vendi, i nxiti të niseshin dhe i shtyu drejt traktorit.

— Ju shkoni, ikni shpejt, se Aleks i po ftohet!

U duk një makinë.

Shoferi frenoi dhe zbriti poshtë.

— E paski nxjerrë makinën? Ju lumtë! Se, për besë, kur e mora vesh sot në mëngjez, më theri në zemër.

Asnjëri s'foli për këtë gjë.

Traktoristi e pyeti:

— Ju po shkoni në Shupenzë, ë? I merrni këta dy shokët. Po rruga si është, mos ka borë, apo akull që ju pengon?

Afër Burimit, fshatit, duhet pastruar një copë vend.

Traktoristi vetëm me triko shkoi të lironte kavon. Shoferi u tha dy të tjerëve të futeshin brenda dhe vetë, si futi kokën në kabinë e rrëmoi poshtë sediljes, doli.

— Merre — i tha traktoristit — se unë kam dy — dhe i dha një peliçe.

— Faleminderit! Po emrin si e ke?

— Vullnetar — qeshi tjetri.

— Ngjituni ju të dy! — përsëriti shoferi dhe i shkeli gazin makinës.

Traktoristi i përshëndeti dhe u nis.

— Shko ti, se unë kam punë — i tha shoferi Aleksit.

Maqina mori drejtimin e kundërt.

Shoferi, si shtroi pallton mbi borë, u shtri edhe vetë e filloi të kontrollonte motorin.

Në majat shkëmbore të maleve po endej një vello e bardhë bore dhe ere që po shtrihej dalëngadalë në luginat e thella dhe në fushat flinte gruri.

YLLKA

U zgjova pak i trembur nga krisma e derës që po hapej ngadalë. Balli më që mbushur me djer-së. Ëndrra që ndërprerë pikërisht atëhere kur së bashku me shokët u hodhëm në ujin e turbullt, që shkumëzonte për të luftuar me të në këmbët e urës. Nga dera e kapanonit vështrova një copë natë që kishte nisur të shuhej. Dikush foli përgjumësh. Ngrita kokën nga jastëku dhe vështrova përreth. Shtrati tjetër afër meje ishte bosh. Nesti mun-gonte. Batanijet ishin rregulluar sikur të mos kishte fjetur njeri. «Ku do të jetë? Ç'punë ka pasur që të dalë në pikën e gjumit?»

Me Nestin isha në një fakultet, por ne u njo-hëm më mirë në aksion, se flinim pranë e pranë në një kapanon. Si zakonisht, së pari këmbuem ga-zetat dhe librat e më vonë hapëm zemrat. Nesti kishte këtu një vajzë. Ata ishin njohur krejt rastë-sisht. Ja si kish ndodhur. Ai kishte shkuar një ditë në një fakultet tjetër për të takuar një shokun e tij dhe kishte pritur në korridor gjersa të binte zilja. Nga shkallët dëgjoji se po zbrisnin duke qeshur dy vajza. Nesti i kishte shikuar me vërejtje dhe për-cudi njëra i kish folur.

Vajza si duket e kish marrë për dikë tjetër. Kur e kuptoi se s'qe ai, e skuqur i kishte dhënë shpejt e shpejt dorën dhe ishte larguar. Ajo zuri për dore shoqen, vrapoi poshtë dhe shkallët kumbuan nga e qeshura e saj.

Më vonë Nesti e kishte takuar edhe një herë. Kjo kish ndodhur në spartakiadën e studentëve. Ajo luante me ekipin e volejbollit. Kur vështrimet u qenë takuar, ajo kish vënë buzën në gaz dhe ky e kishte përshëndetur. Në aksion të dy fakultetet tona qenë në të njëjtin sektor. Nestit i pëlqente shumë të bisedonte me të e mezi i priste mbrëmjet. Mirëpo shpesh s'guxonte t'i afrohej, megjithëse, duke bredhur për t'u takuar me të, e përshëndette katër-pesë herë në natë. «Është një studente e qeshur, thoshte ai. Në fytyrë ka përherë një buzëqeshje të ëmbël dhe të çiltër».

Te Nesti më pëlqente më shumë çiltërsia, mirësia. Isha i bindur se për atë virtyt do ta pëlqente edhe ajo vajza që ai donte, po të kishte rast të rrinte me të disa herë.

...Hapa sytë kur nga qendra e zërit u dëgjua sinjali i fundit i borisë.

Lindja skuqte e purpurt. Ne ecnim në njësh-kolonë buzë kanalit të madh dhe arave me grurë dhe pas pak përshëndetnim agimin. Ladi filloi të këndonte. Kënga sikur na shkundte. Ne hidhnim hapat në traversat e shtruara dhe atje ku mbaronin shinat brigadat ndaheshin e ndaleshin në sektorët e tyre.

Nga prapa dëgjuam një zë si fishë treni. Drejt nesh po vinte një vagon i ngarkuar me traversa. Katër të rinj po e shtynin dhe me ty-ty-ty na lajmëronin që të hapnim rrugën.

— Mirë mëngjezi, komshi!

Ishte Nesti.

— Mirë mëngjezi! Paske ndërruar turnin sot?

— Jo, turni akoma fle! — m'u përgjegi një tjetër. Qe një nga ata tipa që kanë një fizionomi të tillë që, edhe një herë ta takosh, e mban mend.

— Kurse ne ja, po punojmë — vijoi ai.

— Ashtu? — pyeta i habitur e, nga që s'dija ç'të thosha tjetër, shtova: — Bravo ju qoftë!

— Edhe një orë e ca e për ditën e sotme i japim fund — tha përsëri ai tjetri e më shkeli syrin.

Por e pa që këto fjalë s'i kuptova.

— Eja na ndihmo ta shtyjmë një cikë vagonin dhe do ta kuptosh më vonë — më tha ai sikur të më kishte njohur kushedi prej sa kohësh.

U radhita krah tyre dhe shtymë vagonin.

— Dëgjo tashti! Dje në zyrat e shtabit dëgjo-va se kërkoheshin tre-katër vullnetarë nga turni i dytë që, përpara se të fillonte turni i parë, juaji, të transportonin traversa për të shtrirë shinat më tutje. Ata do të punonin vetëm tri orë dhe tërë ditën do të pushonin. U thashë menjëherë se i gjeja unë tre shokë, që do ta bënin këtë punë. Zgjodha edhe Nestin, të cilin erdha dhe e zgjova pas mesnate. Në orën pesë ne kthehemi. E more vesh tashti — e duke ju kthyer të tjerëve tha: — Forca, shokë, edhe një rrugë kemi. Jepi! Foorca!

— A, ti ma paske prishur gjumin — i thashë unë i pakënaqur, se e ndjeva se në atë çast u pezmatova nga fjalët e tij e kjo jo vetëm për gjumin, por edhe për diçka tjetër më të madhe, për Nestin. Dhe po në atë kohë mendova:

«Si paska rënë kaq poshtë, ndërsa unë e njihja për shok shumë të mirë».

Në kthesën pranë lisit shekullor ata ndaluan për të hequr kanatieret, ndërsa unë për t'u bashkuar me shokët. Nga ana e vagonit ku ishte Nesti pashë një tufë zambakësh të bardhë e të freskët. Ishin vënë në një boshllëk midis traversave në mënyrë që të mos prisheshin. Mbi petalet e tyre të gjera e të buta shkëlqente vesa e mëngjezit e ato dukeshin aq delikate, aq të brishta e aq të bukura. Këta zambakë me siguri ai do t'i kishte marrë te pellgu pranë stacionit të ri që po ngrihej.

— Me varkë vajte atje?

— Po, me këto të dyja! — dhe rrahu gjunjët.

— Kujt do t'ja dhurosh?

Ai u afrua duke vënë gishtin në buzë: — Shshëëët!

— Yllkës? — i thashë pa e ulur zërin.

Ai shikoi nga shokët dhe pohoi me kokë.

— Do të vyshken gjer atëhere — i thashë përsëri pa e kuptuar as vetë se ç'ishte ky trill që më nxitte t'i kundërshtoja për çdo gjë që thoshte ai dhe t'ja hidhja poshtë.

* * *

Atë pasdite si zakonisht së bashku me disa shokë shkuaam në shkollën tetëvjeçare të fshatit.

Në një anë dergjej një rrap qindravjeçar, i shkukur, me rrënjët e thara përpjetë e plot zgavra. Ne hipnim mbi trungun e tij dhe shikonim vullnetarët e tjerë që luanin futboll, duke i thirrur një-ri-tjetrit.

Unë u ula mbi rrap, ndërsa shokët u ndanë e

filluan të loznin. Prita të vinte Nesti. Desha ta pyesja për zambakët e bardhë, për vajzën. Por unë desha t'i thosha edhe diçka tjetër që s'më pëlqeu fare sot tek ai. E kjo lidhej me punën. Tani nuk dija si ta përcaktoja miqësinë që kisha me të; më sillte gëzim apo trishtim. E ndjeja se nuk do të provoja atë kënaqësi të ngrohtë që ndjeja kur rrinim e bisedonim për çfarë të na kujtohej. Bile miqësia me Nestin m'u duk e çuditshme. Një ndjenjë tjetër më vlonte në gjoks dhe kallot e duarve sikur më digjnin...

Fusha e Myzeqesë shtrihej si një yll deti me përpjestime fantastike e me shumë zgjatime. Prej andej vinte era e grurit, cicërima e mprehtë e gjinkallës dhe kënga e bashkuar e autokombajnës dhe e myzeqarkave.

* * *

Pas uljes së flamurit shkova në kabanon. Para derës dy veta po luanin domino. Kur hyra brenda, pashë Nestin që ishte shtrirë e po lexonte: «Lexon libra, mendova me vete, por i pëlqejnë qoshet e rehatshme dhe gjërat e vogla».

— Erdhe! — dëgjova zërin e tij.

— Ku humbe? Gjithë pasditen të prita te shkolla.

— Isha në punë.

— Në ç'punë?

— Turni i dytë. Në trase me shokët.

— Vërtet?! — u çudita unë, pastaj shtova: — Apo mos të tha njeri... ti ndoshta këtë rast prisje.

— S'është ashtu. — Ai e la librin menjanë dhe

tregoi i qetë: — Kur u ktheva nga puna, i gjeta shokët të rreshtuar e gati për t'u nisur. E nuk m'u ndenj. Se s'punuam kushedi sa, vetëm tri orë.

Unë e ndjeva thellë gjestin e tij, e kuptova se isha gabuar e, ngaqë s'më erdhi mirë për mendimet që kisha pasur për të, s'e zgjata më.

— Po zambakët ç'i bëre?

Nesti u ndriçua i tëri. Në sy e në buzë i lodroi një gaz i papërmbajtshëm.

— Ja dhe?

— Ou! S'e merr dot me mend si ka shkuar. Kur po kthehesha, të thashë, disa brigada po bëheshin gati të niseshin. Ajo po mbushte pagurin te çesma, në krye të rrugës. Posa m'i pa zambakët, më tha:

«— U, sa të bukura qenkan! Më jep një lule, Nesti!

— Të pëlqejnë? — i thashë.

— Shumë.

Ja zgjata zambakët e duke pëshpëritur i thashë:

— Yllka, unë... për ty i mblodha...

— Me të vërtetë e ke?»

— Po, për nder. Nuk e di se si më erdhi, por ja thashë — buzëqeshi me drojtje ai.

* * *

Desha të ngrihesha. Pandeha se mos ra boria e zgjimit. Por kapanoni flinte. «Hej, dreq, sa gjumë të lehtë që kam», mendova. U ktheva nga ana tjetër, por pak më tej dallova një hije.

— Ej, kush je ti?

Hija lëvizi nga vendi.

— Çfarë do?

— Desha pak Nestin.

— Ç'e do në mesnatë.

— Po ja për... kishim një punë. — Ai më qe afruar dhe nga fizionomia unë njoha atë shokun e Nestit, vullnetarin me të cilin bisedova djekur shtymë vagonin.

— Mos e zgjo! — i thashë i mërzitur. — Iktashti! Nesti është i lodhur.

Vullnetari u përtyp dhe iku. Dera u hap përsëri me krismë.

— Kush ishte? — Nesti ishte zgjuar.

— Ai shoku yt i...

— Ku shkoi?

— I thashë mos të të zgjonte.

Ai u ngrit.

— Ku po shkon?

— Duhet vajtur, — tha ai — se s'pret puna.

Turni juaj do traversa për të shtruar shinat. Duhet çuar në vend.

U vesh dhe doli.

U mendova. «Traversat duheshin transportuar patjetër sido që të ishte puna».

U ngrita edhe unë.

Territori i qytezës ishte i zbrazët, e i qetë.

Pranë një shtylle elektrike Nesti po bisedonte me atë djaloshin tjetër.

— Ku i keni shokët?

Asnjeri s'më foli.

— Nuk do të shkoni sot?

— Shokët s'vijjnë — tha ai tjetri. — Duan të punojnë me turnin.

Unë e kisha mbledhur veten.

— Vij unë — u thashë atyre.

— Vërtet?.. — më pyeti Nesti dhe e preu

fjalën. Bëri disa hapa përpara dhe u drejtua për-
diku.

— Yllka! — u dëgjua befaz zëri i tij.

Ktheva kokën. Një vajzë me trup mesatar po
vinte drejt tij. «Po kjo thashë, apo mos i ka thënë
gjë Nesti». Dhe ashtu kishte ndodhur. Në bisedë e
sipër, ai i kishte folur për punën e mbrëmshme dhe
i kishte thënë se dy shokët e tjerë nuk do të vinin.
Dhe vetëm kaq.

Vajza na dha dorën. Ajo dukej e ndriçuar si
me spektrin e dritës.

— Nisemi! — tha Nesti.

Një pjesë rrugë nuk folëm. Kur u afruam tek
arra e madhe, e tërhoqa për mënge vullnetarin
tjetër dhe, si u larguam, i shfryva në vesh:

— Po ti, mor buf, s'e kupton që ata duhen lënë
vetëm!

Mua sikur më vlonte përbrenda e desha t'i
derdhja gjithë inatin që më ishte mbledhur kundër
tij.

Në stacionin e ri ku ishte vagoni, karrocet dhe
tokmakët qenë renditur si ushtarët në pozicion.
Vagoneta ishte ndaluar pranë stivës me traversa.

I morëm një nga një traversat dhe i ngarkuam
në vagonetë.

Ngulëm këmbët në zhavorin e shinave, u kërru-
sëm, mbledhëm muskujt dhe e shtymë përpara.
Rrotat e vogla mezi lëvizën. Pastaj vagoneta u lë-
shua në shinat pak të pjerrëta. Tek ura mbi përrua
traseja ngrihej dhe ne e patëm më vështirë dhe djer-
simë. Sidoqoftë rrugën e parë e bëmë shpejt.

Që kur qemë nisur, shoku i Nestit nuk e kishte
hapur gojën. Nesti i tha:

— Çfarë ke? S'më dukesh mirë.

— Jo! — tha ai.

— Ku ishe dje?

— Dje... hë, u vërtita kot dhe, e di, më erdhi ashtu... shumë rëndë. Nja tre shokë të viteve të para më pyetën përse s'kisha shkuar me turnin... më thanë mos isha i sëmurë. E, hëm, atë kohë më ngjau sikur u sëmura.

— Pse ç'pate?

— S'e di. Ndjeva përnjëherësh dhembje koke dhe filluan të më merreshin mendtë. Shkova në kapanon dhe u shtriva. Më vinte të qaja.

— Po ti vetë e kërkove këtë gjë?

— Mendova se s'do të ishte keq të pushonim nja dy ditë për t'ja nisur me forca të reja, por u... gabova.

— Po sot si do t'ja bësh — e pyeta unë.

— Një herë u bë ajo.

E shikova me një sy tjetër. Shoku i Nestit m'u duk i mirë i dashur. Edhe Nesti e vështroi me dashuri dhe, duke shtyrë vagonin i shtrëngoi dorën. Ai uli kokën dhe ne dëgjuam frymëmarrjen e tij të thellë e të vështirë. Dukej se zemra i luftonte në kraharor.

Kështu e kishim ngarkuar përsëri vagonetën dhe, pa u ndjerë, ishim vënë përsëri në udhë. Vagoneta ecte shpejt dhe ne shtynim gjithnjë e më shumë.

...Kur po ndaheshim, Nesti u drejtua nga pellgu pranë stacionit për të marrë zambakë të bardhë.

— Prit! — i tha shoku i tij. — Po vij edhe unë.

— Ç'të duhen ty?

— Po ti përse i merr? — ja ktheu ai.

Nesti vështroi Yllkën, që ishte skuqur dhe desh të ulte kokën. Qeshëm. Buzëqeshi edhe Yllka.

I përshëndeta dhe u drejtova për atje ku brigada ime shtronte shinat.